

## INTERVISTË ME REXHEP FERRIN

Prishtinë | Data: 5 dhe 6 shkurt 2020

Kohëzgjatja: 203 minuta

Të pranishëm:

1. Rexhep Ferri (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Kaltrina Krasniqi (Kamerë)
4. Jakup Ferri (djali i Rexhep Ferrit)
5. Renea Begolli (Asistente e kamerës)

*Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## **Pjesa e Parë**

**Rexhep Ferri:** Po historia e shqiptarëve ma shumë osht’ legjendë se sa që është histori. Këtë e them sepse jo brezi im, por edhe brezi i gjysh pas gjyshit {lëviz dorën në mënyrë të shkallëzuar} jonë eduku edhe jonë formue dhe kanë krijuar personalitetin ma shumë nga legjendat, nga mitet, sesa nga historia e shkruar. Ne edhe shumë vonë e kemi mësuar rrugën e shkrimit kujor, jo vetëm të çirilicës ose të latinishtes ose të shkrimit arab, për arsye se gjithmonë kemi qenë me armikun shumë afër dhe na ka trokitë te dera. Në popullin shqiptar familjet që kanë qenë dikur të njohura që ne i kemi pak a shumë edhe i rujm për veprat e tyre në histori, e kanë pasë një jetë tragjike, një besim të madh në, në, në jetën e vet edhe në, në, në burrninë e vet për ta rujt edhe personalitetin. Ato familje e kanë krye misionin e vet, kështu që edhe vorret e tyre janë pothuajse të humbuna. Na s’kemi vorre, një vorr e kemi në Plavë {ngrit gishtin tregues}. Origjinën që e kemi, me origjinë nga Plava, Jakup Ferri, një varr është {ngrit gishtin tregues}. Mirëpo, ai brez që e ka majt në rrethin e vet popullin shqiptar kanë qenë patriotë tanë të cilët nuk janë si këta patriot të tashit.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundeni me spjegu qysh kanë qenë?

**Rexhep Ferri:** Ata çdo gjë e kanë dhanë. Nji shembull shumë i thjeshtë, Haxhi Zeka në Pejë ka qenë një plak shumë i njoftun. Haxhi Zekë Byberi i thojshin, ai s’ka pasë fëmijë edhe e ka shitë pasuninë edhe i ka dhonë paret njerëzve tjerë që, “Shkoni bleni armë, se unë jam plak. Djalë s’kom për me dhonë me shku në luftë, bleni armë e shkoni ju në luftë”. Hasan Prishtina e ka shkri pasuninë e vet për me mujt me bo nji punë kombëtare, nji punë të ndershme për popullin e vet. Dhe Hasan Prishtina ka qenë një njeri, që ka qenë si personalitet shumë i njoftun edhe në oborrin mbretëror të sulltanit në Samboll. Kështu që, në rrethin e kësaj familjes, këtyne familjeve të mëdha që kanë qenë dikur tragjike, ka qenë edhe familja ime. Gjatë katër luftave kanë luftu edhe jonë vra, kanë luftu edhe jonë vra, kanë luftu edhe jonë vra edhe kurgjo s’kanë trashëgu. Na kanë lonë ne rrugave. Une e maj në mend si fëmi kur baba im ka qenë në Kukës mësus.

**Erëmirë Krasniqi:** Në cilat vite ka qenë atje?

**Rexhep Ferri:** Po, para 85 vjet, 80 e... se unë 83 i kom une.

**Erëmirë Krasniqi:** Mhm, ma merr menja që gjatë '40-tave, 1940.

**Rexhep Ferri:** Ku ta di, jo more, jo përpara. Dhe si familje e madhe duhet me fillu me Luftën e Parë Ballkanike, kur Plavën e Gucinë e Kosovën, Evropa ja u jep Malit të Zi, Plavë e Guci, Ulqin e Tivar. Kosovën ja jep Sërbisë dhe gjatë asaj lufte, Jakup Ferrit i vriten tre djem e dy nipa dhe gjyshi im ka qenë në Stamboll dhe del në, nga Stambolli del në Shkodër dhe e mbledhë krejt familjen e vllaznive të vet dhe i qet në Shkodër. Në Shkodër atëherë kanë qenë baba im e dy tjerë që i ka pasë Hasan Ferri, gjyshi im të vllaznive të vramë Riza Ferri e Shemsi Ferri. Kanë qenë në shkollë në Shkodër, dhe Hasan Prishtina t'u pasë miqësi me Jakup, me Hasan Ferrin, e lutë për me ja dhonë tre djem, tre nipa të Jakup Ferrit për me i lëshu me studiu në Itali. Gjyshi im Hasani nuk e çon djalin e vet, babën tim, po i çon dy djemtë e vllaznive të vramë Shemsi Ferrin dhe Riza Ferrin.

Më tregonte nana, tha, “Baba ish konë idhnu se i kish pa mprehë dhomtë me shku me studiu, e Rizën ose Shemsën me çu në, në Pukë {tregon me gisht majtas} me Migjenin atje, me ja marr rrogën si mësus”. Dhe nuk e çon babën tim, babën tim e çojnë atje në Tropojë. Në Tropojë baba im martohet. Prej Tropoje ka qenë një kohë kur shqiptarët kanë qenë 90 përqind pa shkollë, por e kanë pasë një shkollë tjetër shumë ma të, ma të moralshme sesa që e kemi ne sot. Mësusit që msojshin, e bojshin një praktikë, e çojshin tash me çelë një shkollë tjetër dikun, e nga Tropoja e çojnë në Pukë {tregon me gisht majtas} me çelë shkollë Puka, babën. A në Tropojë e bijnë një mësus të ri, i cili ky i ka vnu disa themele. Prej Puke mandej e çojnë në Kukës, ku une kom lind në Kukës.

Në Kukës unë e maj në mend, kam qenë tri vjeç, dy vjeç gjënë e parë e maj në mend, e maj në mend se shtëpia ku kemi banu me qira aty ka qenë dy katëshe edhe ka qenë shtëpi orientale. Ne kemi qenë në katin e dytë edhe dritaret kanë qenë të kthyme ka një rrugë kryesore, ka një rrugë e gjatë, mu më dukej si një rrugë e gjatë. Po flas për një fëmëni une, une kur kom qenë tri vjeç, dy vjeç e gjysmë, tri, qishtu. E maj ne mend kur nana pat dalë në dritare kom dalë edhe unë në dritare edhe ajo më ka rreh {lëviz dorën} dhe e mbaj në mend një plakë {ngrid gishtin tregues} e vogël e cila gjithmonë vike mas meje, ajo ka qenë gjyshja ime, nana e nanës. Nuk e mbajë në mend hiç a ka pasë ftyrë, a s'ka pasë ftyrë? Veç e di që ka qenë e vogël dhe e ka pasë një fistan ngjyrë kafe të mbylltë me pika të bardha, vetëm qeto e maj në mend. Ato si siluetë, po flas tash figurativisht si me qenë fillimi (qesh) i kësaj që une kishe u bona piktor.

Dhe prej atyhit mandej u bo lufta e, në Shipni hyri Italia, knej hyni Hitleri dhe atëherë u prish kufini dhe u ba në njifarë mënyre jo Shipria e Madhe, se nuk duhet me thanë Shipria e Madhe, por Shipria Etnike, se osht' ma e kapshme edhe ma e moralshme. Shipria Etnike, Shipria e atyne shiptarëve, e atyne tokave që janë të tyre. Dhe Ernest Koliqi ka qenë një shkrimtar shumë i nderum, një, një figurë shumë e ngritun nga Shkodra, në Itali ka studiu, ai ishte në atë kohë Ministër i Kulturës edhe i Arsimit. Edhe pse ishte koha e Italisë, ajo i kishte vu shiptarët nëpër institucione dhe në Kosovë e pruni shkollën shqipe dhe të gjithë ata shqiptarë që kanë qenë me origjinë nga Kosova, e kur thomë nga Kosova ju nuk e dini edhe shumë shiptarë të Kosovës nuk e dinë si Kosovë quhet të gjitha trojet që janë jashta kufinit që osht' sot Shipnia. Mujo Ulqinaku, nga Ulqini që osht' vra në Durrës, kosovar i thonë.

**Erëmirë Krasniqi:** Ka qenë si term i përdorshëm?

**Rexhep Ferri:** Për të gjithë, se e ka marrë Kosovën, për arsye se Kosova ka qenë si territor ma i madh dhe të gjitha territoret tjera {hap duart} që nuk kanë mbet mrena kufinit të Shqipërisë janë qujt kosovarë edhe Kosovë u qujt. Tashti janë jo shqiptarët e Malit të Zi, jo shqiptarët e Kosovës, jo shqiptarët e Maqedonisë, jo shqiptarët e Preshevës, si puna jonë mahallë, mahallë. Dhe babën tim e caktojnë me shku në Plavë me çelë shkollën shqipe.

**Erëmirë Krasniqi:** Kështu që u kthyt prapë te familjarët?

**Rexhep Ferri:** Eh. Dhe ne kthehemi, kthehemi. E mbajë në mend, kthimin nuk e mbajë në mend se si jemi kthy, vetëm e mbaj në mend si në Prizren te Shadërvani në një pemë është nalë ai kamioni që na ka marrë neve, na ka pru deri aty, a çka ka qenë, me çka kemi ardhë nuk e di. Nana ime me ne të vogjël, une tre vjeç, katër vjeç edhe vëllau im ka qenë, motrat kanë lind mandej në Plavë dhe shkum në Plavë. Baba im kthehet në Plavë, ka shku dhetë vjeçar dhe kthehet tashti me çelë shkollën shqipe. Në krejt atë territorin nëpër ato katune, në Plavë, e në Guci e nëpër ato katune që jonë aty me çelë shkollën shqipe. Mu më lind në Plavë, më lindin tri motra dhe unë nuk e mbaj në mend, por e mbaj në mend nana ime, e ka nxjerrë baba një lirë që {sikur nxjerr diçka me gishta prej xhepit} e ka pasë në xhep edhe ja jep...

**Erëmirë Krasniqi:** Nanës.

**Rexhep Ferri:** Nanës, thotë, qe thotë, “Shtinë në fiokë dikun”, unë edhe e kom pa jom shku e kom marrë, e jom dalë në qytet edhe e kom lyp një xherdan {prek qafën}, xherdan me kësi omëlcina për motrën, për Dritën që m’ka vdek, edhe e kom lyp një xherdan. Ai thotë, ai më thotë mu... une nuk e mbajë në mend këtë punë, po nana ma ka thonë, më paska thonë ai pronari i dyqanit {sikur mbanë monedhë}, “Shko çoja nanës edhe thuj që deshte me ble xherdanin për motrën tonde, po kjo pare nuk shkon, le ta jep një pare tjetër e hajde”. Edhe unë kom shku te nona i kom thonë, “Nuk po bojka kjo deshta me ble”. Kjo osht’ kujtimi i parë. Mandej kujtimi tjetër i mavonshëm është kur vishin te ne plot oborri u mushte se ishim shpi e madhe. Ajo fama kanihere kushton shumë shtrenjtë.

**Erëmirë Krasniqi:** A kishit familje ju në Plavë në atë moment kur u kthyt?

**Rexhep Ferri:** Po, ishim...

**Erëmirë Krasniqi:** Familje ma të gjonë po mendoj.

**Rexhep Ferri:** Po, familje ma e gjonë, po si jo ishte, ishin, ishin rritë këta nipat e Jakup Ferrit, ishin bo, {numëron në gishta}, njeni ishte kryetar i Ballit Kombëtar, tjetri ishte kryetar komune, baba drejtor shkolle, i të gjitha shkollave andej, udhëheqës i vullnetarëve, vijshin me luftue, ishte kohë lufte, kohë lufte. Dhe vishin në oborrin tonë, e kemi pasë një oborr shumë të madh. Vishin kerret me kuaj të, nuk kishim ushtri, ushtri të disiplinume me gjenerala, me oficera, me, me... vishin me marrë misër, i kishim hambarët plotë, si në bashqe të babës merr sa të dush e ço për ushtarë, hajde, hajde, hajde. Dhe këto kanë qenë rrugët e asaj kohe të atyne patriotëve, jo të këtyre patriotëve të tashëm.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh po thu osht' ndje Lufta e Dytë Botërore në qat' oborrin e juj, veç po më intereson qysh kanë luftu?

**Rexhep Ferri:** Dhe, dhe ka qenë, na kena pasë, familja jonë kemi pasë shumë lidhje me këtë katunin {tregon me dorë para vetes} e [Zenun Çelës](#), Qosajve.

**Kaltrina Krasniqi:** Plavë?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo katuni...

**Kaltrina Krasniqi:** Gucia?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo, Gucia është qytezë e vogël, po kjo, Rexhep Qosja prej kahit osht' bre?

**Jakup Ferri:** Vuthaj, jo?

**Erëmirë Krasniqi:** Vuthaj.

**Rexhep Ferri:** Vuthaj, eh ne kemi pasë ma së shumti lidhje me Vuthajt dhe kemi pasë edhe miqësi me ta dhe të gjithë... se osht' një, osht' një tragjedi mrenda kombit shqiptar që me shekuj ndoshta i ka kushtu shumë shtrenjtë edhe atëhere edhe dej tashti. Atëhere folshin në Plavë e në Guci serbisht, se gjuha shqipe osht' gjuhë e katunarve. Se s'ishte asnjë njeri me shkollë shqiptar, boshnjakët po edhe në Plavë e në Guci u folte serbisht, në katunet e Plavës e Gucisë e deri në Vuthaj u folte shqip, edhe këta ishin shqiptarë. Dhe vishin tek ne gjithë këta të katunit se ishin vullnetarë në luftë dhe ka qenë një Çelaj, një kushëri i zonës Çelës edhe i jep nana me hongër edhe ai ja len pesë fyshekë, paqetën e fyshekëve {shpjegon me duar} për babën. "Leja Shabanit qete, se une jom tu shku në luftë edhe nuk kthehna mo vallahi", i thotë nanës. Parandjenja te njeriu.

Mas dy ore ose tri ore po ma merr menja, ose, po jo ma shumë, mrena asaj dite e maj në mend kur e kanë pru të vramë në oborr tonë dhe në vigë. Nana e merr një avli edhe ja qet përmi tesha {tregon me duar trupin e tij} se ai ish me tirqi kënde, e mlojnë edhe e çojnë. Edhe e maj në men njëherë kur une jom smu, këto jonë kujtimet e para në Plavë, vishin këto... nuk e di sesi me i qujt, nuk kanë qenë lypëse po kanë qenë do falltore, që ti merrshin mentë e qitshin fall e knej andej {lëviz duart para vetes}. Edhe vijnë, vijnë edhe nana del edhe dal une edhe ato qysh më kanë kqyrë e tek më kanë kqyrë, a ka në jetë najfarë rrezatimi a nuk ka, ku ta di une, kom qenë shumë i vogël. Filloi mu të më dridhet toka nër kambë {dridh duart} edhe ishte ai cungu i drurit afër, unë hipi mbi cung me pshtu se i vogël, qaq i vogël sa që unë hypi aty tu menu se po pshtoj se po me dridhet toka. Edhe kom bërtit edhe jom smu aty une edhe e di që kom hekë nga ajo traum një kohë.

Mandej, u kry lufta shqiptarët nuk muj me i gjyku shqiptarët pse shkojshin me luftu në Spanjë {ngrit dorën tregon djathtas} me e bo Spanjën komuniste, a në shpi të vet në shtetin e vet, e në kombin e vet

rrumpallë e kishin, gjo s'kishin në dorë. Po nejse, në atë kohë, ka qenë njëfarë idealizmi me qenë komunist, krejt Evropa e re ka qenë rinia, ka qenë me idealet e komunizmit.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh qarkullojshin qato idea, a keni naj...

**Rexhep Ferri:** Po, në Shqipri në atë kohë Tajar Zavalani e ka përkthye “Nanën” e Maksim Gorkit. Krejt rinia e Shqiprisë që ishin nëpër shkolla e lexojshin “Nanën” e Maksim Gorkit. Edhe në mëngjes kur shihshin që t'u kanë ajë pak sytë {prek sytë}, “Aha, paska lexu ky sonte, tanë natës s'paska fjetë, paska lexu” {tregon me gisht para vetes}. Qaj Tajar Zavalani që e ka përkthi atë, ai e pa se çka është komunizmi dul mandej e majke Radio Londrën. E nana ime u mytke tu e ndigju {vendos dorën te veshi} “Po bjen sot komunizmi, po bjen nesër komunizmi”. Qysh njeriu nga njëri skaj shkon në skajin tjetër. Kur jemi kthi ne në Gjakovë...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh keni vendos me shku në Gjakovë, ose qysh, qysh ka ardh deri te ajo...

**Rexhep Ferri:** Për arsye se neve na konfiskun krejt pasuninë edhe baba, baba, baba nuk, baba iki, dulë, ai nuk... ai ka mendu që do të pshton në Gjakovë, nuk do të ketë nevojë me lonë familjen, se prej Fadil Hoxhës e deri te Sahit Bakalli, i ka pasë shokë shkolle edhe ka qenë mësus me ta bashkë nëpër Malësi të Gjakovës. Po u takum me Sahit Bakallin, përpara se me u taku me këta... edhe i thotë Sahit Bakalli, “Shihe Shaban, ti sonte nuk guxon me të nxonë nata në Gjakovë. Ne nuk mujmë me të pshtu prej sërbëve edhe prej malazezëve, se je nipi i Jakup Ferrit, i Hasan Ferrit, vëllau i Riza Ferrit, i Shemsi Ferrit që kanë udhëheqë luftën kundër partizanëve edhe vet je konë me ta. Por ti duhet me dalë me shku në Shqipri, në Tropojë, ku ke qenë mësus, ku i ki miqtë tu atje se je i martum edhe kalon kjo furtunë dhe pshton disi”. Edhe e përcjellë e qet nga qyteti e shkon baba anej dhe ne mbesim.

**Erëmirë Krasniqi:** Ju mbetët në Gjakovë?

**Rexhep Ferri:** Ne mbetëm në Gjakovë. Nana punonte tanë natën në vek, dhe të hanën ia çojke në mëngjes, ka qenë një malësor, po njeriu kajhere kur osht' i vetmum, vetëm a osht' njëri që i dinë dy fjalë shqip i duket si me pasë vëlla. Ai i thojke motër nanës edhe kjo vëlla, e nuk ishin as të njëjtë katun, as të njëjtë qytet po të Malësisë të Gjakovës. Pashkë, daja Peshk i thojsha une. Edhe ka qenë njëri pa shkollë, po e pike {afron gishtat te goja sikur pi duhan} duhanin si aristokrat - qashtu më dukej mua atëherë - me një cigarllëk. Edhe ja çojke nana me ia shitë ato tesha, ato në vek çka bojke nana edhe ai ja lshojke një grusht rrena nanës, “Zoja Hatixhe, kom dëgju prom Radio Londrën thanë qishtu, komunizmit s'ka me i nxonë java *tap-rrap* {onomatope}”. Dhe nana me atë rrenë e kalojke javën. Atëherë vike e hanja tjetër opet ja lshojke naj rrenë edhe kalun vitet e ne u rritëm.

## Pjesa e Dytë

**Erëmirë Krasniqi:** Metëm te lajmet që nana jote i merrte për komunizmin.

**Rexhep Ferri:** Po.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundesh me ma spjegu këtë pjesë, a ka të boj me shpresën që ajo e ka pasë me përfundu komunizmi edhe familja m'u bashku?

**Rexhep Ferri:** Po, për ata që e hupin luftën, humbja e luftës së atyre që e kanë fitu luftën osht' fitore e tyre. Humbja e komunizmit, me fjalë të tjera ndikimi i sllavëve në trojet shqiptare e humbte vlerën e vet, e humbte sundimin e vet. Se në Gjakovë, gjakovarët komunistë që ishin prej Fadil Hoxhës e teposhtë nuk guxojshin prej sërbeve me e mbrojt babën tim dhe i thanë, "Ik Shaban mrena natës, largohu". Dhe shpresa po e mbante njeriun dhe ne sinqerisht me thonë na ka rritë një nanë, një nanë e pashkollë, një nanë e paprofesion, profesion fitimprurës, po. Dhe u rritëm edhe pse e kishim pushtetin në sy të keq.

**Erëmirë Krasniqi:** Ju kishin në sy të keq.

**Rexhep Ferri:** Vishin, vishin natën me na kontrollu të SUP-it<sup>1</sup>, do, do bile të këtyne që punojshin kishe si, ata ishin analfabeta po i kishin marrë si argatë edhe vishin me na kontrollu.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju bojshin pyetje? A çfarë lloj kontrolle?

**Rexhep Ferri:** "Ku e ki burrin?" Ia bojshin nanës. Edhe nana nuk ja u çelke derën. Kemi pasë kojshi një komunist Qumil Xuna. Edhe thojke, "Shkoni thirrne Qumil Xunën, atij ia çeli derën, e juve nuk ua çeli derën". Dhe ata erdhën, vishin disa herë dhe na u detyrum mandej me e lëshu Gjakovën e me shku te tezja jonë, një dhetë kilometra prej Gjakove në katun, në Bobaj të Bogës, me ikë prej tyne.

**Erëmirë Krasniqi:** Po, po.

**Rexhep Ferri:** Po ata edhe atje vishin, se ata ishin dhe të katuneve. Dhe unë nuk e di se kur i kanë marrë, e kishin marrë gramafonin {numëron në gishta}, e kishin marrë radion, i kishin marrë pllakat. Zogu i ka pa botue një pesë pllaka të gramafonit, për gramafon të mëdhaja asi {me duar tregon amdhësinë} në Bullgari, hera e parë që jonë botu në gjuhën shqipe pllakat dhe i kishin marrë ato. Maqinën e shkrimit, që në krejt Gjakovën s'ishin dy maqina të shkrimit {tregon dy gishta}, nana ime e kishte maqinën e shkrimit të babës tim. I kish marrë njoni, nana e kish majtë në men. E tregoj ma vonë këtë ngjarje ose p'e vazhdoj...

**Erëmirë Krasniqi:** Vazhdoje.

**Rexhep Ferri:** Po e vazhdoj. Mas një 30 vjete ose 25 vjete, qaj person që i kish marrë, tash kish ra ish metë me ardhë me kqyrë sa, sa ki shpenzu korrent. Edhe nana p'e njeh, edhe pse kanë kalu aq vjet edhe po i thotë, "Hajde urdhno," tha, "hyn mrenda se po du me ta qit ni kafe". Ai met pa menë, nuk... çka po don kjo gru, tash ish nana edhe ma e vjetër, atëherë ka qenë e re e bukur, "Jo, jo", tha, "hec,

---

<sup>1</sup> Sekretariati i Punëve të Brendshme në Jugosllavi.

hec se”, tha, “a të kujtohet kur ke ardhë?” Tha, “M’i ke marrë”, tha {numëron në gishta} “maqinën e shkrimit të burrit, radion, gramofonin, pllakat, këtë, këtë”, tha, “edhe kurrë s’mi ke kthy”. Tash ai kish ra, se...

**Erëmirë Krasniqi:** Nuk ish mo në pushtet.

**Rexhep Ferri:** Po, edhe unë, “Me kon e ka kjo gru që po bon kështu, po, po kacafytet?” Une dal në krye të shkallëve e shoh, ai në derë kishte {zgjat pëllëmbët e duarve para vetes}, s’e kish lonë me hi kjo mrenda, në derë ja ka thonë këto fjalë edhe ai hala nuk ka hi me kqyr sa kemi shpenzu na korrent orën. Ai ka qenë një burrë i trashë, i kuq, e nga turpi ish kuq edhe ma shumë. Unë vet e di që, vet e di që ka qenë një ftyrë e kuqe, e kuqe si m’u konë njeri që e ka kqyr drejt me sy diellin. Edhe kthehet e ikë, e len, as s’e kqyrë orën, as kurgjo hiç. Kështu që, mrena kësaj kohe, kjo koha kur vjen ky me marrë atë, vëllau im 17 vjeçar ka qenë në klasë me Ali Podrimën dhe i kanë bo fjalët me ikë, me shku në Shipni. Ishte moda siç ka qenë në kohën e Sërbisë që kanë dalë Fadil Hoxha, ata krejt, me shku me kry shkollën shqipe se s’kish shkollë shqipe në Kosovë. Vjehrra ime ka qenë në klasë të parë qitu në klasë të parë në Prishtinë në shkollë sërbe.

Dhe Ali Podrimja nuk shkon, shkon te Besim Bokshi, te profesori i vet edhe i thotë që po don me ikë në Shipëri edhe ai i thotë, “Po, veç qeto vjersha që po i shkrun këtu...” Se ky ia çojke do vjersha profesorit vet me ia kqyr, a i ka të mira, a s’i ka të mira, “Këto vjersha atje s’ki me i shkru”. Edhe vëllau i vetëm ka dalë në Shipëri edhe u taku me babën mas, mas tre muje. *Ehee* {onomatope}. Po baba, baba ka pasë një autoritet atje, mik të ngushtë e ka pasë Aleks Budën. Në librin e Aleks Budës, ai tregon Aleks Buda se si ka shku me vizitu, unë i kom pasë pesë urime të vitit të ri që ia ka çu Aleks Buda si kryetar i Akademisë së Shkencave, Shaban Ferrit në atë kutinë e vogël {tregon me duar madhësinë}. Po ti, ti i ke hup [i drejtohet Jakup Ferrit] (qesh).

**Erëmirë Krasniqi:** A kishit mujt nashta veç pak tash kur tregoni për vëllaun me na tregu edhe për babën pak ma shumë, sa informacion keni pasë për to edhe çfarë jete ka bo ai atje?

**Rexhep Ferri:** Për te ne kemi marr vesh që është gjallë... Ai ka shku me 1944-tën, e kemi përcjellë unë edhe nana dej në dalje të qytetit, ai me një mantill bojë hiri, me një sheshir {ngrid dorën te koka}, frynte një frymë e madhe, ai s’ish përthaku {prek gjoksin}, një çantë e kishte në krahë {prek krahun} edhe ai po i thotë, “Shko”. {lëviz dorën para} Kjo atëherë ka qenë, nuk ja bojke me dorë, se femrat kanë qenë atëherë pak ma, nuk kanë qenë të hallakatme si tashti, femra përpara nuk hike vetëm në kafe, tash hijjnë edhe mirë osht’, mirë osht’, mu m’pëlqen.

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë ka qenë ma e rezervume.

**Rexhep Ferri:** Po, ‘44-tën kjo osht’. Ne kemi marrë vesh që o gjallë me 1955-tën.

**Erëmirë Krasniqi:** *Uaaa* {onomatope}.

**Rexhep Ferri:** Mas njimdhjetë vjete e kemi marr vesh që baba o gjallë.



**Erëmirë Krasniqi:** Qysh, qysh, prej kahit erdh lajmi, çka ke burimi?

**Rexhep Ferri:** Ah, po ai kufi Tropoja edhe Gjakova o 20 kilometra. Nana ime ka qenë në Gjakovë, gjyshja ime në Tropojë. Mas dhetë vjete a 15 vjete ka marrë vesh nana ime që i ka vdekë nana. Qaq ka qenë ai kufi i egër, jo i egër po... mos me ta marrë mendja që osht' realitet. Si m'u kujtu tashti Edit Durham<sup>2</sup>, kur e ka ndëgju në Shkodër, kur ka zbrit ajo për herë të parë te shqiptarët e ka ndëgju kongën, që i ka vra ajo kosovarja, se kosovare ka qenë ajo familje, burrin e dy djemtë se ja ka vra burri, ja ka, ja ka dorëzuar dy vllaznit, e dini atë kangën?

**Erëmirë Krasniqi:** Po, po.

**Rexhep Ferri:** Po, kur e ka ndëgju, "Kur ja ngula thikën burrit si t'mu çunë vllaznit nga vorri, po kur ja ngula thikën djalit si t'i nxorra sytë e ballit" dhe kur e ka ndëgju Edit Durham ka thonë, "A osht' e vërtetë kjo, apo është sajim?" "Jo", kanë thonë, "e vërtetë osht' se ka ndodhë në Shkodër. Të çojmë me pa edhe shpinë ku ka ndodhë". Prandaj, ato realitete që po thom une të kufinit jonë, nuk mundet njeri me i marrë si realitete por si sajime, si me qenë tuj shkru romane, tuj fantazu e tuj bo andej, qaq ka qenë ai kufi i çuditshëm. Por me gjithë ato vështirësina, me të gjitha ato varfni të asaj kohe, njerëzit kanë pasë ma shumë personalitet sesa që kanë sot. Njerëzit kanë qenë ma të afërt me njoni-tjetrin sesa që jonë sot, dhe kanë qenë ma bamirës sesa që janë sot. Dishin me nda të mirën e të keqen bashkë dhe të gjitha këto realitete e kanë pasë një rrugëdalje, shpresa i ka majt gjallë.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh e morët ju lajmin për babën që është gjallë, kush ua komunikoj?

**Rexhep Ferri:** Nji dajë na çon nji fotografi të babës dhe e kemi atë fotografi të babës.

**Erëmirë Krasniqi:** Përmes kujna?

**Rexhep Ferri:** A?

**Erëmirë Krasniqi:** Përmes kujna, qysh ka ardhë, a ka pasë komunikim në najfarë niveli?

**Rexhep Ferri:** Ai daja, jo tash mbiemri ynë, po i shkrun nanës si motër knej e anej, "Qe ta çova fotografinë e Shabanit", kishe ai s'pi thotë burrit tond, po si me thonë po ta çoj fotografinë e babës, a të vllaut a anej, anej edhe na e marrim edhe na e njofim babën.

**Erëmirë Krasniqi:** Domethonë letrat, ka qenë e mundshme me çu letra?

**Rexhep Ferri:** Po, veç ajo letër bojke gjashtë muj deri vike. Dhe vëllaut, vëllau në Shipëri nuk ka hjekë keq, por e ka pshtu baba, se baba ka qenë, jo që ka qenë naj diplomat kështu, por e ka ditë që në çfarë

<sup>2</sup> Mary Edith Durham (1863-1944) ishte një udhëtare, artiste, shkrimtare britanike që u bë e famshme për shkrimet e saj antropologjike rreth jetës në trojet shqiptare, në fund të shekullit të XIX dhe fillim të shekullit të XX.

regjimi po jeton edhe si duhet ta ruaj personalitetin e vet. Të ndahet i kënaqur me atë që e ka sot për sot. Ne mandej u shkollum në Gjakovë, nana ka vujt shumë për djalin, për vëllaun që dul në Shipni se dul i ri.

**Erëmirë Krasniqi:** A u befasat ju me vendimin e tina me shku në Shqipni, apo ka qenë e...

**Rexhep Ferri:** Po qysh s'u befasum. Edhe ai, "Në atë sekond" tha, "që ka ardh ushtari me m'marrë", se vetëm kish pasë ikë, tha "jom pendu".

**Erëmirë Krasniqi:** Ushtari i Shipnisë?

**Rexhep Ferri:** Tha, "Se ish konë ma i zi se ushtari i Sërbisë". "Ha, a erdhe ti të vdisësh, hecë ore, hajt mshelne, ding" {sikur hedh diçka me forcë}. Në vend se me pyet a po don ujë a diçka, a një gotë ujë a diçka, jo veç {hedh dorën tutje}. Kështu që, ne u shkollum.

**Erëmirë Krasniqi:** Në Gjakovë?

**Rexhep Ferri:** Në Gjakovë, po. Une, fillimet e mia kanë qenë libri, letërsia. Nuk po them se ne shqiptarët e kemi si babë të romantizmit Naim Frashërin, por mu më pëlqente ma shumë Mjeda.

**Erëmirë Krasniqi:** Mjeda.

**Rexhep Ferri:** Dhe poezitë e Mjedës më kanë bo që une të fillojë me shkru.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka shkrujshit edhe a osht' moshë e hershme kur ju keni fillu me shkru?

**Rexhep Ferri:** Po ishte, ishte shkolla fillore kjo.

**Erëmirë Krasniqi:** A vetëm reflektojshit apo edhe ato ishin...

**Rexhep Ferri:** Edhe osht' e çuditshme që librin e kom dashtë ma shumë se sa që kom lexu libra.

**Erëmirë Krasniqi:** Veç si objekt (qesh).

**Rexhep Ferri:** Une fola për një dobësi time. Ma shumë lexon një nip i imi tashti në moshën, qaj Lisi që thashë, sesa që kom lexu une në moshën e Lisit. Po atëhere ishte një kohë, një kohë shumë e vështirë. Edhe në Pejë kur kom shku mandej në shkollë, në Gjakovë vetëm një libër ka qenë në librari "Tufa" e Latif Berishës, kurrnjifarë libri në gjuhën shqipe. Në Gjakovë që ishin 99 përqind shiptarë, libraria ishte plot me libra serbisht, vetëm një libër {ngrit gishtin tregues} ishte në gjuhën shqipe, një, një {me gishta tregon trashësinë} fletore me 30 faqe. Ose në Pejë kur kom shku në shkollë të mesme, po për Pejë po flas mandej. Dhe një profesor mi sheh mu vizatimet, po jo profesori i vizatimit, një profesor tjetër që kishte studiu në Itali, po s'e kishte kry shkollën se lufta e ka ndërpre anej. Por, kishte pa pak dyjanë, "A ti tek je për shkollë të mesme të artit", për shkollë të mesme të artit {ngrit duart}, për herë të parë kom

dëgju për shkollën e mesme të artit. Dhe mandej fillova me nxansat tjerë që ishin ma të mirë në vizatim, nëpër klasë tjera, të shoqnohem e t'i kqyri, t'i bojmë vizatimet bashkë e anej e... dhe shkova në Pejë, në provim pranus.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh vendosët, a patët përkrahje, familjen mas vetit?

**Rexhep Ferri:** Me nanën, me nanën, po. Me nanë e pa pare hiç. Hyna në provim, u pranova, ishte edhe internati, shumë herët pata fillu me u gjind edhe ishte lehtë me i shkru ato firmat atëhere {ngrid dorën sikur shkruan} jorganxhi e, qebaptore, rrojtat e... Edhe une ja u shkrujsha ato firmën prej, dhe fitojsha diçka sa për me hangër, sa me pagu. Nana më çojke diçka. Ai Qumil Xuna që e kishim kojshi, ai e pat shti nanën në punë mandej në Gjakovë, në fabrikë duhanit, me palu duhon. Dhe disi u gjindëm, e kreu shkollën e mesme të artit t'u mendu që aty mbyllet dhe do të dal në Skivijan. Skivijani një katun është nga Peja, para se me shku në Gjakovë, nja, nja tri kilometra para se me hi në Gjakovë ose pesë. Thojsha e blej një bicikletë e në atë shkollën e atjehit e jap vizatimin, se në Gjakovë, Gjakovarët kanë me i shti njerëzit e vet. Ajo ka qenë që mujsha me ëndërru që...

**Erëmirë Krasniqi:** Ma e mundshme.

**Rexhep Ferri:** Do të jetë ma e mundshme edhe e ardhme e jetës sime.

**Erëmirë Krasniqi:** A po rrimë pak në Shkollën e Mesme të Artit, a mundesh me m'tregu pak ma shumë për qat' ambient shkollor, meqenëse ka qenë institucioni...

**Rexhep Ferri:** Shife, aty nuk po thom se ata na kanë dashtë profesorat, gjithë kanë qenë serbë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka qenë edhe në serbisht edhe në shqip a qysh?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo në serbisht ka qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** Aha, okej.

**Rexhep Ferri:** Në serbisht ka qenë. Të gjithë kanë qenë profesorat serbë edhe kanë qenë fëmijët e çetnikëve disa pi tyne profesorëve. Por formimi i personalitetit nuk të len me u korit, une nuk e di që një profesor në Shkollën e Mesme të Artit, kishte shumë edhe serbë aty kishte se Gjakova, Peja ka qenë atëhere e mushne me malazetë, me malazetë. Kështu që gjysa prej tyne kanë qenë malazet edhe disa shqiptarë, vetëm një vajzë ka qenë shqiptare. Dhe nuk na kanë kqyr shtremt, si ata si neve na kqyrshin, nga asnjë profesor kur thom, thom edhe për Beograd {tregon mrapa me gisht}. Pos njeri që m'ka nguc njihere, s'ka rëndësi. Dhe ajo shkollë ka qenë shkollë e mirë, dhe une mas shkollës dola, varfnia çka s'bon, nuk mujsha me andru që do të muj me studiu se Beogradi atëherë ishte shumë larg.

Kur them shumë larg, une isha, kisha dalë si mësusi i vizatimit në Pozharan, Pozharani osht' te, te Ferizaji {tregon me gisht majtas} dhe për natën e Vitit të Ri, unë në mëngjes, me 31 dhjetor, në ora 8:00

dal aty në rrugë me prit farë autobusi, farë diçka me ardhë deri në Ferizaj e me shku natën e Vitit të Ri me prit në Gjakovë dhe kom përfundue në Prizren, s'kom mujt me mrri në Gjakovë. Prandaj, thashë, Beogradi atëherë ishte shumë larg. Dhe kur mrrina në Prizren ora shtatë, tetë mramje s'ka çka me bo. Hoteli, ai ishte përgaditë për përgaditjen e Vitit të Ri, ishin shitë biletat e senet, e knej-anej. Te Shadërvani aty, ka qenë në skejt aty {shpjegon me duar} një, një kafe dy-katëshe, nalt kanë qenë një tri dhoma të vogla si për *fakira*<sup>3</sup>, si për të varfun ashtu. E mora një dhomë une nalt për me flejt, zbrita poshtë, hangra, nuk e pisha duhanin por e kisha marrë një libër me vete, gjithmonë kom nejt me libra, nuk i kom lexu bash ashtu si duhet, shpesh {sikur shfleton} do faqe i hiqsha.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ka ndodh?

**Rexhep Ferri:** Se kur është libri shumë i trashë s'mujsha me i ra në fund. Kështu që, këtë e tegova si një tregim për me tregu se sa larg edhe sa e pakapshme për imagjinatën time që me shku me studiu në Beograd. Por ishte një kohë shumë e viteve '50-ta, '55, '58 kur i qitshin profesorët prej pune, "Jo s'jeni, s'jeni për me eduku ju rininë, s'jeni t'përshtatshëm nuk jeni..."

**Erëmirë Krasniqi:** Ideologjikisht të papërshtatshëm.

**Rexhep Ferri:** Po, po. Edhe unë atëherë e kam pasë një mik profesorin e gjuhës shqipe, një Kadri Kusarin, ai ka vdek, ka 20-30 vjet, 30 vjet i ka që ka vdekë, një dhetë vjet i ka hongër burg e... edhe më thotë, "Rexhep, shife ti ik sa ma shpejtë nga Kosova se ty këtu të pret burgu".

**Erëmirë Krasniqi:** Si familje e persekutume në sy të pushtetit.

**Rexhep Ferri:** Po. "Po, si?" "Hajt se gjinesh, hajt se gjinesh". Se ai e kish kry e dike Beogradin. Edhe kur jom nisë me shku në provim pranus në Beograd, ka dalë ni teze e imja Nasibja, me m'përcjellë në autobus, se nana, hera e parë {ngrit gishtin tregues} që ka qenë nana ime në spital. Edhe une kur më tha, se para se të niset autobusi një ditë përpara ose nuk e di shkova e pash në spital, kur i thashë që po shkoj edhe po më tregon në cilin vend jonë, "Merri qeto pare". Une i mora gjysën, gjysën e lashë. Nasibja, tezja ime më ka përcjellë, një peshkir ma ka pru edhe Kadri Kusari {sikur heq orën nga dora} e ka hek orën e dorës edhe ma ka dhonë. Ai u bo se bep që jom shku, "Ik bre prej këtuhit". Por atëhere miqësia ka qenë me shumë besim. Unë i kom besu atij si ta kisha pasë babë ose vëlla të madh edhe e kom ndëgju kur më ka thonë. Dy here e kom ndëgju ato, njëherë e kom ndëgju kur kom shku në studime, dytën herë e kom ndëgju kur hi për flamur '64-tës.

**Erëmirë Krasniqi:** '64.

**Rexhep Ferri:** Atëherë kom...

**Erëmirë Krasniqi:** A nuk ka qenë '68-ën?

---

<sup>3</sup> Turq.: *fakira*, varfanjak.

**Rexhep Ferri:** Si?

**Erëmirë Krasniqi:** ‘68-tën po e di, po...

**Rexhep Ferri:** Jo, jo ‘68-tën, për flamur Adem Demaçi që i rراسi në burg 120 vetë

**Erëmirë Krasniqi:** Po, po e di.

**Rexhep Ferri:** Që i kanë kepë flamurat në Turqi, i kanë kepë dhetë në Turqi e tjerët ni Zot e di se ku jonë kepë, po nejtse, s’himë, nuk po hijmë se politika osht’ e rrezikshme. Dhe në Beograd...

**Erëmirë Krasniqi:** E çka ju tha ‘64-tën ai juve, çfarë këshille ju dha?

**Rexhep Ferri:** Po erdha une në pushime nga Beogradi në pushime, kish fillu këtu në Kosovë, nëpër qytete të Kosovës me u bo organizata për...

**Erëmirë Krasniqi:** Bashkimin e Trojeve...

**Rexhep Ferri:** Për kepjen e flamurëve dhe për shkepjen e flamurëve.

**Erëmirë Krasniqi:** (qesh)

**Rexhep Ferri:** Edhe në Gjakovë ishte, për Gjakovë ishte kryesori po më duket ky Kadriu, Kadri Kusari. Kur më ka pa...

**Erëmirë Krasniqi:** Ky profesori, a ka qenë ai edhe i përfshimë në këtë farë akcioni a?

**Rexhep Ferri:** A?

**Erëmirë Krasniqi:** Ky profesori ose miku, a ka qenë i përfshimë në këtë akcion?

**Rexhep Ferri:** Po ai ka qenë kryesori për Gjakovë. “Çka dreqin” tha, “të ka pru bre?” Thashë, “Po pushimet Kadri”. “Ti”, tha “nesër ik, nesra mos me të pa këtu”. Une nonës ja kisha pru teshat me m’i la, ajo i kish la, të lagta, të lagta une teshat i mora edhe shkova. Edhe domethonë dy herë më ka pshtu nga jeta, a veten s’e ka pshtu. Une s’kom pasë vëlla të madh, po ato e konsideroj që e kom pasë, edhe jom rrit pa babë por kurrë nuk kom... nonën e kam pasë aq të fuqishme saqë kurrë nuk mendoj që jom rritë pa babë, për arsye se babën e disha që o gjallë.

## Pjesa e Tretë

**Rexhep Ferri:** Në Beograd kanë qenë profesorat jashtëzakonisht human dhe jashtëzakonisht profesionalista t’mirë edhe nuk kanë bo dallime nga kush je, a je serb, a je çka je, a je kroat, a sloven,

a shqiptar, a çka je. Çka kanë pasë mrenda nuk po flas, por kështu ne nuk kemi vërejt gja. Bile, ja u tregoj një rast që nuk osht' mo ajo serbi, as ata serbë të atëherit tash. Vitin e dytë shokët e klasës m'thonë, "Ferri çoja ti indeksat tonë doktor Pavlo Vasicit me na dhonë nëshkrimin", se kta serbtë e Beogradit ishin pak të lazdrum e vagabonda, "se kur të sheh ty nuk egërsohet e ta jep nëshkrimin". Po si me shku bre, kurrë s'kisha shku në sallën e arsimtarëve. Trokis unë në derë. Ai ka qenë plak, ka qenë doktor i poetikës së artit, e ka pasë të kryme edhe historinë e artit edhe Akademinë e Artit në Paris. I kishin ra syzat {prek syzet e tij} edhe po thotë, "Hajde Ferri, pse po hin aq turpshëm?" Kishte qenë t'u shkru në tavolinë diçka. "Po ti m'je ma i vjetër se grekët në Ballkan".

**Erëmirë Krasniqi:** Shqiptarët, a po?

**Rexhep Ferri:** Unë atëherë këtë nuk kisha hyp në këtë top-listë ku e kom tash, këtë mendim të tij, por s'e kom harru kurrë edhe na i dha nëshkrimet. Nuk ka serb që thotë çka ka thonë doktor Pavlo Vasici atëherë, që je ma i vjetër se grekët në Ballkan. Ne kemi qenë me fat që i kemi pasë ata profesora.

**Erëmirë Krasniqi:** A mundesh me tregu veç pak për prapavinë e ktyne profesorave se e di që shumë prej tyne kanë qenë të arsimum nëpër qendra të mëdhaja evropiane edhe ata kanë jep mësim mandej në Beograd. Qysh ka qenë ajo përvojë m'u arsimu majdej prej atij kuadri? Edhe sa ka qenë dallim i madh prej përvojes arsimore që e keni pasë ktu? A mundesh me na tregu edhe për atë tranzicion që e keni pasë prej ktu me shku me një vend si Beogradi edhe me ju ekspozu ideve aq të avancume.

**Rexhep Ferri:** Normalisht që masa e madhe edhe e popullsisë serbe nuk ka qenë e ngritur, ka qenë vetëm elita e aristokratëve të paraluftës të ngritur, ata i kanë shkollu fëmijët. Kështu që, shokët e klasës, ne kemi qenë shumë të afërt, por dallimi mes profesorëve tanë që i kishim në Beograd dhe atyne që ishin në Paris ishte dallimi shumë i vogël. Se unë kom qenë edhe në Académie des Beaux Arts si asistent ma vonë edhe i kom pa se çfare jonë profesorat atje edhe çfare kanë qenë profesorat e mi në Beograd, për arsye se ishin eduku. Emancipimi e bon t'veten, shkollimi e bën t'veten, besimi në rrethin ku jeton dhe rrezatimi mes personave që ti po komunikon ndikon te njëri-tjetri. Nëse ulesh pranë zjarrit ku është flaka e madhe, në ftyrën tone ka dritë të kuqe ma shumë se sa dritë të zbehtë.

Kështu që, ka qenë një kohë që unë mendoj për mu ka qenë një kohë e artë dhe normalisht kur e kom kry unë në '66-tën, '67-tën, mandej e kisha e kisha harru Skivjanin, që do të bona mësues në Skivjan, por s'ma merrte mendja as në Prishtinë, dojsa me shku në Paris. Dhe nana ime, e cila ka qenë po ashtu e një familje të madhe me shumë tragjedi edhe asaj babën ia kanë pasë vra, edhe nga baba im, nga familja ime e gjyshit edhe ashtu kisha një respekt shumë të madh, jo vetëm se e kisha nanë, por ndaj jetës së saj. 40 vjet s'e ka ditë, a e ka burrin gjallë a jo? Kurrë s'ka thonë qysh m'la ky burr me fshi rrugëve. Kurrë! Na t'gjithë kemi nanë edhe ju keni nana, por ka nana që kane hekë shumë. Me një shkrim timin që e shkrova këto ditë, një nanë që ja kanë vra djemtë, katër djem. A thu a e kanë ditë për çka po vraren? A thu për këtë ditë a?

**Erëmirë Krasniqi:** Zoti Ferri a po kthehem në Beograd për...

**Rexhep Ferri:** Beogradi pa marrë parasysh se çfarë raporte, sa vujtje ka përjetu populli shqiptar nga miqësia dhe armiqësia me popullin serb, me serbët, për mu, për neve që kemi studiu në Beograd, Beogradi ka qenë qyteti i rinisë sonë edhe unë kom shumë kujtime nga Beogradi për arsye se jom sjellë në rrethe të poetëve, shkrimtarëve, të njerëzve që kanë qenë të emancipum edhe të kulturum dhe që kanë pasë personalitet krijues dhe shumica prej tyre kanë qenë ma të vjetër se unë. Ka pasë që kanë qenë profesora të mi edhe unë kom nejt me ta dhe unë kom msu prej tynë dhe gjithmonë e kom pasë nifarë kërkese që t’jom me dikond që din ma shumë se unë. Jo të vjedhi diçka nga ai, por të dëgjoj diçka çka s’kom ndëgju kurrë dhe mos t’më shpëton diçka që m’vlen për jetën e me msu kur t’len jeta.

Kur fillon me t’lonë jeta, po mendoj, me msu kur mundesh me shfrytëzu. Në krijimtari çdo gja fillon me lecka. E ka Vasko Popa<sup>4</sup>, ka qenë një poet shumë i madh Vasko Popa dhe e ka një poemë, “Kthemi lecat e mia” dhe unë kom msu shumë nga qata njerëz që kanë ditë ma shumë se unë, por m’vjen keq që jom vonu për me mujt me mrrri për ta realizu veten edhe ma mirë.

**Erëmirë Krasniqi:** Pse kjo ndjenjë?

**Rexhep Ferri:** Hë?

**Erëmirë Krasniqi:** Pse kjo ndjenjë që jeni vonu?

**Rexhep Ferri:** Po, a din pse? E shoh që unë në krijimtarinë time unë kom shkru poezi gjatë viteve të ‘60-ta. Gjatë viteve të ‘70-ta kom fillu me shkru prozë, e në vitet e ‘80-ta kom botu edhe romane. Gjatë viteve të ‘90-ta, 2000, 2010 kom fillu të shkruj ese. Në pikturë kom pasë me hap ekspozita e ekspozita por s’i kom hap. Erdhen deomstratat e kom pasë një ekspozitë në Paris, erdhen domostratat edhe met ekspozita e dytë pa e hap në Paris edhe s’u hap. Domethonë, në njëfarë mënyre jom vonu për një sekond, por për një sekond nuk e kom marrë medaljen e artë, e ka marrë dikush tjetër.

Nuk osht’ kjo te unë ai xheloz, osht’ një kërkesë pse nuk e kom realizu veten, se kom mujt me realizu veten edhe ma shumë, kom pasë besim në vetvete. Xhelozinë ma ka humb ai galeristi që e kom pasë ekspozitën në Paris me ‘77-tën, ku shkroi *Le Monde*. Erdhen në *Le Monde* edhe galeristi m’qet përtej rruge me ma qit një kafe, se kqyr për interesin e vet. Tre hapa, gjatë atyne tre hapave më thotë, “Mëkat që nuk je spanjoll”, e kishte interesin e vet për m’u shit pikturat ma shtrejt e ma mirë. “Por je shqiptar, i një kombi të panjohur”.

Atëherë sa kishte dalë libri i Kadaresë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” frangjisht edhe atë ekspozitë që ma ka pasë hap mu në Baske, ai ka shkru ma s’pari për Ismail Kadarenë se e ka pasë shumë mik. Kjo fjala që nuk je spanjoll, s’paskan pasë me më pengu mu spanjolltë. Ishte gallë në Paris atëherë Picasso

---

<sup>4</sup> Vasile “Vasko” Popa (1922-1991) ishte poet serb me origjinë rumune. Z. Popa shkroi në një stil modernist që i referohej më shumë surrealizmit dhe traditave popullore serbe.

<sup>5</sup>, Salvador Dali<sup>6</sup>, Miró<sup>7</sup>, me qindra e qindra ishin botnore, ishin t'mushun muzetë e të gjithë botës me pikturat e ktyne. Po paska pasë me më pengu një x, y në Prishtinë, ose një x, y në Tiranë edhe ai galerisë sa ma shumë, se kjo punë i ka...

**Erëmirë Krasniqi:** 40...

**Rexhep Ferri:** Jo, 50 vjet e ma shumë, 50 vjet i ka, në '77-tën.

**Erëmirë Krasniqi:** 40, 43 jo ma shumë. (qesh)

**Rexhep Ferri:** Ai m'ka kthjellë, m'ka ndihmu shumë me një fjalë që unë s'ja kom kthy përgjegjen, as ai s'ka thonë një fjalë, e kemi pi një kafe dhe unë prej asaj dite ndoshta jo, por me kohë e kom vorrosë atë xhelozinë time, xhelozinë egoiste. Unë nëse jo xheloz, por e shoh që ti je para meje atëherë e lus Rexhep Ferrin që të punon edhe dy orë ma shumë edhe tri orë ma shumë, sesa që ka punu për me mujt me dalë para teje. Sikurse në gara që jonë, ti ushtron vrapimin për një sekond tri orë në ditë, unë duhet me ushtru katër orë në ditë për me mujt me dalë para teje. Kjo osht', kjo nuk o xheloz.

**Erëmirë Krasniqi:** Konstruktive, xheloz, konstruktive.

**Rexhep Ferri:** Po.

**Erëmirë Krasniqi:** Ju ndihmon m'u zhvillu ma tutje.

**Rexhep Ferri:** Osht' shumë konstruktive edhe shumë njerëzore. Prandaj, Beogradi edhe Parisi m'kanë ndihmu. Kur kom shku për herë të parë në Paris, Parisi akoma ka qenë ai i artit. Kultura pas viteve të '80-ta në përgjithësi 1980 e knej, ose edhe tash ka fillu të mos jetë shumë kërkuese se njerëzit nuk po kanë mo kohë për diçka shumë kërkuese. Nëse jeta i ka pasë njëqind shije, sot i ka njëmijë shije. Njerëzit po mundohen në çdo mënyrë nga morali e deri te jomoral, çdo gjo e përdorin për me mujt me u bo të famshëm e me mujt me materializu jetën e vet. U harru mo ajo me realizu jetën e vet, por me materializu jetën e vet. Me shekullin e XX-të u bë kjo ndarje dhe mu djali im më thotë, "Pse je kaq ti në artin tond dramatik me këto", por jeta ime osht' shumë dramatike.

Në vitin e parë të studimeve në Beograd, në landën e skulpturës na dha si detyrë profesori një javë na me ja bo portretin njoni-tjetrit edhe ma boni portretin tim një maqedon dhe kur erdh profesori p'e kqyr, tash për portretin tim po thotë, "*Prava rimsak glava*", kokë e vërtetë romake, e ashpër. Kanë qenë shumë të diciplinum ushtarët romak, jeta i kish' bo ata të ashpër. Nuk e kom ktu unë tash me ja u tregu. Qe ai portreti atje {bën me gisht në të djathtën e tij} osht' i madh në një faqe të librit, ai aty.

<sup>5</sup> Pablo Ruiz Picasso (1881-1973) ishte një piktor spanjoll, skulptor, poet dhe dramaturg që kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij të rritur në Francë.

<sup>6</sup> Salvador Dalí (1904-1989) i lindur në Figueres, Kataloni. Dali ishte një artist surrealist spanjoll i njohur për aftësitë e tij teknike, hartimin e saktë dhe imazhet e mrekullueshme dhe të çuditshme në punën e tij.

<sup>7</sup> Joan Miró i Ferrà (1893-1983) ishte një piktor, skulptor dhe qeramik spanjoll, i lindur në Barcelona. I takon periudhave të surealizmit, fauvizmit, ekspresionizmit abstrakt, kubizmit.



Portretet e shqiptarve nuk janë të lëmut {prek ftytyrën}, janë të prem si me sakic, të gdhendun *rram, rram, bam, bam* {onomatope} dhe jeta ja ma e ashpër që osht’ edhe shpirtëroren e ka jo vetëm të ashpër, por edhe ma të fuqishme, se don me rezistu, osht’ me gjak të pazbutun. Ai miku im që m’ka ndihmu me hap ekspozitën në Paris, që ka qenë mik i...

**Erëmirë Krasniqi:** Kadaresë?

**Rexhep Ferri:** Kadaresë, për herë të fundit që jom taku me ato në Paris, në shpi të tij ma thonë për një mik të vetin që nga Kroacia për Kërlezhën [Miroslav Krleža]<sup>8</sup> që kish me botue. Tha, “Po ju botohet Kërlezhës kryevepra në frangjisht, se të gjitha të tjerat ju kanë botu, por kryevepra”, ajo ka qenë ma e dendun. Tha, “Kom frikë që ne franqezët nuk do ta pranojmë, edhe pse ai është shkrimtari ma i madh nga Ballkani”.

**Erëmirë Krasniqi:** Ai ka qenë shumë i rëndësishëm edhe për artin në momentin kur është shkëput arti prej realizmit edhe ka kalu...

**Rexhep Ferri:** Po, po ai ka qenë.

**Erëmirë Krasniqi:** Ai e ka bo atë diskutimin kryesor.

**Rexhep Ferri:** Ai me Titon. I vetmi njeri ka qenë ai Kërlezhë që Titos i ka thonë, “Ti”, jo, “Ju” edhe e ka ndëgju Titoja edhe.... “Osht’ shkrimtari ma i madh” tha, “por, ajo osht’ pak e randë për ne franqezët, se neve franqezëve na u ka zbut gjaku”, e ne ende e kishim gjakun e pazbutun. Ai djali im e ka gjakun e zbutun për shkak se i ka shku jeta edhe brezi yt, shyqyr që jeni në këto mundësi që i keni, veç me mujt me pshtu prej qityne që na kanë bo rrumpalë Kosovën. Prandaj, arti im deri para nja pesë vjete ose tetë ishte ma dramatik edhe ishte ma me pak, nuk thom me ma pak ngjyra, por të gjitha ngjyrat ishin të mshefura, mrenda një ngjyre, dy ngjyrave, tri ngjyrave për arsye se çdo gja e kisha në dhimbje.

## Pjesa e Katërt

**Rexhep Ferri:** Demonstratat na i kanë pru, na i kanë sjellë. Por edhe ne profesorët kemi ndihmu aty, për arsye se brezi im e ka pasë kompleks me hy n’luftë me serbin, me hy n’luftë me një armik të fortë, e kishim kompleks. Ishim të vetëdijshëm sa lufta i kemi humbë dhe studentët tanë t’u na u dhonë neve në Kosovë një liri për hapjen e shkollave, për zhvillimet kulturore. Në të vërtetë ishim lidhë, nëse dojmë me fol për artet pamore, t’lidhun me Beogradin, se Shkolla e Mesme e Artit profesorët ishin shumica nga Beogradi, shumica. Dhe ne, ata i kishin kry shkollat, ata i kishin kry shkollat, ishin fëmijët e aristokratëve që i kishin kry shkollat edhe në Paris. Kështu që, nuk e patëm edhe aq të vështirë me përjetu shkuarjen nga një provincë në një kryeqytet, se për ne atëherë në Ballkan, i vetmi që ne aty nuk e njifshim, por që ishte si kryeqytet evropian ishte Beogradi dhe Zagrebi.

<sup>8</sup> Miroslav Krleža ishte një shkrimtar kroat dhe një figurë e shquar në jetën kulturore të të dy shteteve Jugosllave, Mbretërisë dhe Republikës Socialiste.

Noshta e kemi pasë por jo edhe aq të adaptohemi. Kemi qenë ma të varfun se sa që kanë qenë të tjerët, por në shoqni ajo edhe nuk vrehet për arsye se të rinjtë janë edhe shumë solidar. Kështu që, kurrë nuk e kom ndi vetën mes të tjerëve që ishin të kombeve tjera, që unë jam i një kombësie, por krejt ishim bashkë sikur të ishim rritë bashkë në një lagje. Mu tetë vjet që kom studiu e specializu e krejt në Beograd, se Akademia ishte pesë vjeçare, një semestër me mbrojt diplomën, shkalla e tretë apat dy vjeçare edhe një semestër me mbrojt, ato u bonë shtatë vjet, tetë vjet u bonë. Kështu që, mu gjatë tetë vjete kush s'ma ka thonë një fjalë të keqe në pikëpamje kombëtare, nuk m'ka ofendu në pikëpamje kombëtare. Noshta edhe ka qenë një kohë e atyne profesorëve edhe atyne kolegëve të mi, shoqeve të klasës që nuk i kanë pasë paragjykimet, për arsye se edhe shkolla e pasluftës në Jugosllavi ka qenë një shkollë e orientume ka evropianizmi, jo nga nga kishat e nga bizantizmi. Kështu që, e ndijshim veten si unë si ata e androjsim Parisin.

M'kujtohet një rast kur djali i atij shtëpiakut të Akademisë, se Akademia e ka pasë edhe shtëpiakun e vet, banesën menjëherë ngjit me Akademinë, aty ata edhe fshijshin edhe pastrojshin, e majshin një kafe, pijshin kafe dhe djali i tyne shkoj një herë, ishte shofer në njëfar Ambassade, shkoj në Paris edhe krejt na u mbledhem për me na tregu se si osht' Parisi. Kond po e pyesim, një shofer që nuk dinte, ishte me një shkollë te mesme, nuk e di se çfarë shkolle e ka pasë.

Por, e mbaj mend një fjalë prej tij që mandej e kom pa që ka qenë shumë e vërtetë, tha, "Në Paris bre vlla gjithkush punon, jo punën e vet, punon në një punë tjetër. E ka kry gjeografinë punon si portier". S'di a po më kupton? Osht', ka qenë shofer ka met me fshi rrugët knej e anej. Kështu që, kërkush nuk e bon punën e vet. Kjo ishte ajo që ai e kishte pa edhe ish' shku e kish pa për me na tregu neve, ish' shku edhe e kishte pa edhe Luvrin. Por tash, masi po e përmendi Luvrin edhe unë edhe të gjithë ne e androjsim. Unë nuk mujsha me shku gjatë kohës kur kam qenë student për dy arsye, se nuk kisha pasaportë dhe unë kom studiu tetë vjet pa bursë, shkaku i familjes sime që nuk ishte në krahun e partizanëve për arsye të vjetra familjare, historike.

**Erëmirë Krasniqi:** A ishte kjo njo prej arsyeve që nuk kishit pasaportë?

**Rexhep Ferri:** Hë?

**Erëmirë Krasniqi:** A ishte edhe kjo arsyeja pse nuk keni pasë paraportë?

**Rexhep Ferri:** Po, unë isha i regjistrum në Shqipëri atëherë, se kom lind në Shqipëri. Kështu që, unë edhe nana ishim shtetas të Shqipërisë. Kështu që, mandej kur unë, po nalem te Beograd ma mirë. Në Beograd në fillim e kom pasë pak vështirë me u gjetë. Ka qenë një profesor që m'ka ndihmu në fillim, i cili ka qenë profesor në Pejë edhe ai shkoi në Beograd.

**Erëmirë Krasniqi:** Cili ka qenë?

**Rexhep Ferri:** Miša Đorđević. Dhe ai filloi me punu në televizion të Beogradit dhe atëherë nuk ka pasë, televizioni ka pasë nevojë për reklama dhe t'gjitha reklamat në televizor atëherë u bojshin me dorë, i

vizatojshin. Prej shkonjave deri te çdo mesazh tjetër që osht’ figurativ dhe Miša më merrte me i ndihmu unë, me i bo tellopat, ato shenjat, me ja zmadhu skicat, me ja ekzekutu skicat me ja bo. Kështu që, unë fillova atë që e bojsha në Pejë dyqaneve që ja u bojsha firmave, fillova në Beograd nga puna ime bukur e vështirë, por duke e sakrifiku kohën time të lirë të jetoj.

Unë gjithmonë kam qenë modest, nuk kom çu një jetë, i plotësojsha kushtet me pagu një konvikt ose një banes t’vogël. E kom pasë një dhomë njëherë, e kom mbajt nja tri vjet a katër dy me tri edhe për mu ka qenë dhoma e rinisë sime, dhoma ma e mirë e jetës sime (buzëqesh). Qaq e ka edhe Jakupi, po e ka lonë tash atë dhomë, tash e ka marrë krejt të naltën. Në Beograd, unë meqenëse isha i dhonun mas letërsisë edhe e disha serbishten fillova të lexoj por jo të shkruj.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh e keni msu serbishten? Nëse kishim mujt me përfshi.

**Rexhep Ferri:** Shkolla e mesme ka qenë serbisht pesë vjet.

**Erëmirë Krasniqi:** A e keni pasë problem?

**Rexhep Ferri:** Po, osht’ deshtë me msu. Edhe unë aty kom fillu t’i lexoj shkrimtarët e mëdhaj botëror që ishin, ne ktu s’i njihshim edhe s’i kishim. Unë kom, ishte dallimi shumë i madh, por i riu i kap gjanat ma shpejt sesa mund të jetë ndoshta, nuk e a është ma i shpejt zëri apo shiqimi, por unë mendoj se shiqimi është ma i shpejt. Shiqimi i të riut i kap gjanat shumë ma shpejt sesa ndoshta mund t’i kap zëri. Unë në Beograd i kom pa dramet e Becket-it, kur në Prishtinë luhej “Kryet e hudrës”, një dramë e një muhalife, ose e Kristo Floqit<sup>9</sup>, “Kushëri nga Amerika”, qysh osht’ ardh kushëri nga Amerika edhe tash krejt po ngojn çka ju ka pru. Kështu që, mirëpo edhe Kosova filloi shumë shpejt, çdo ardhje e ime nga studimet e shihsha një...

**Erëmirë Krasniqi:** Zhvillim?

**Rexhep Ferri:** Një zhvillim. Mu m’ka ndodhë për shembull në Prishtinë, se i kisha shok shkrimtarët, me shku me një kafe që ka qenë kafe e ushtirsë te Grandi te ajo shpia që...

**Kaltrina Krasniqi:** Kino Armata?

**Rexhep Ferri:** Në Armata, po aty ka qenë një kafe edhe mu s’më lan me hi, s’më lan me hi isha me dy gazetarë të “Rilindjes”, s’më lan me hi se unë i kisha flokët e gjata (qesh). U bo ajo punë shumë e madhe, kur vjen nesër me më thirrë ai oficeri me më lyp falje, knej anej, (qesh) pak një humor a di. Kështu që, shumë shpejt mrrinin, fryma i sjell gjanat ma shpejt se sa që mendon njeriu. Dhe në Beograd pos që e kom përcjell artin botëror...

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë ekspozita vishin? A kishe mujt me na...

---

<sup>9</sup> Kristo Floqi (1976-1951) ishte një patriot, dramaturg, politikan dhe avokat shqiptar.

**Rexhep Ferri:** Po unë në Beograd, para meje ka qenë në Beograd ekspozita e Henry Moore-it<sup>10</sup>. Më 1951 ka qenë ekspozita e Henry Moore në Beograd. Unë e kom pa në Beograd ekspozitën e artit modern të Amerikës, një koleksion të Amerikës. Kur ishte pop arti atëherë në modë dhe për mu ishte një risi me pa pop artin dhe ishte një xhup i një ushtarit amerikan të Vietnamit edhe ai xhepin sesi e ka pasë ktu. Një qytetar i Beogradit e ka pasë gazetën “Politika” në dorë, ja fut në xhep. Por unë shkojsha dy herë, tri herë me i pa ekspozitat e tilla dhe gjithmonë isha sikur se ju [i drejtohet intervistuesës] me një laps e fletore në dorë, e merrsha naj shënim a naj send. Kur shkoj të nesërmit, unë e shoh ajo “Politika”...

**Erëmirë Krasniqi:** Kish intervenu dikush (qesh).

**Rexhep Ferri:** Kishte intervenu. Kështu që, kishte pak reagime në atë kohë nga ata që ishin në ombrellën e realizmit socialist, se kishin ra ata edhe... Mirëpo, politika e Titos artin e ndau nga realizmi socialist, nuk ishte edhe e lehtë atëherë. Ka pasë reagime, nuk ka në art ndalesa por unë ju përkushtova shumë pikturës e jo letërsisë atëherë.

**Erëmirë Krasniqi:** A keni studiu për pikturë apo grafikë?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo, pikturë. Jo, letërsisë sepse fjala lexohet edhe fjala mund të keqkuptojhej, fjala të rrsheet e lexohet, e kuptohet, e t’kushton nëse politikisht e ke një pikëpytje dikund. Por, unë edhe si student kom fillu të prezentohem në ekspozitat, qofshin ato që kanë qenë në Beograd edhe përjashta. Jo vetëm unë, por me ta thanë të drejtën para meje ka qenë student atje Muslim Mulliqi, Gjelosh Gjokaj, Matej Rodiqi, Shemsedin Kasapolli.

**Erëmirë Krasniqi:** Ai ka jep tani msim në Shkollë të Artit të Mesmen.

**Rexhep Ferri:** Po, ai ka qenë tani profesor i imi në Pejë. Këta kanë qenë gjenerata e parë e shqiptarëve që kanë studiu edhe disa të tjerë që s’po më kujtohen, kanë qenë edhe njo dy të tjerë. Gjenerata e dytë tani vijmë ne, unë, Tahir Emra, Xhevdet Xhafa, vjen Daut Berisha, Fatmir Krypa e shumë e shumë tjerë. derisa u krijun kushtet që ne ta hapim në Prishtinë. Ndërtesa e parë ose shkalla e parë e Universitetit të Prishtinës ka qenë Shkolla e Lartë Pedagogjike, dhe aty ka qenë seksioni i arteve dhe aty tu ju falenderu Muslim Mulliqit, ka qenë një shkollë e artit jashtëzakonisht e mirë. Dhe ende kishte nga Shkolla e Mesme e Artit e Pejës që na vishin me një kulturë figurative mjaft të mirë, saqë gjatë kohës që unë kom nejt si profesor e kom mrrri që ma përpara me pranu njo me gjimnaz sesa me shkollë të mesme të artit. Shkolla e Mesme e Artit kishte shku nga një skaj në skajin tjetër. Nuk osht’ aty noshta edhe i profesorëve ose faji i studentëve, nxanësve, por faji i atyne që e bojnë orientimin sesi të profilizojmë një shkollë. E bonë si një shkollë të zanatit edhe deri ku ka mrrri nuk e di, por në atë kohë e kom pa që kishte hyp në skija edhe nuk e di se ku ka mrrri me shku.

<sup>10</sup> Henry Spencer Moore (1898-1986) ishte një artist anglez. Ai është më i njohur për skulpturat e tij bronziale gjysmë abstrakte, të cilat ndodhen në të gjithë botën si vepra arti publik.

**Erëmirë Krasniqi:** Ma shumë për Shkollën e Lartë a mundeni me na tregu? Qysh erdh deri te themelimi?

**Rexhep Ferri:** Por, mos me pasë qenë qajo Shkollë e Artit e viteve, se ajo osht', Shkolla e Mesme e Artit osht' hap me 1949, unë kom qenë me '54, gjenerata e pestë. Mos me pasë qenë ajo Shkollë e Artit në atë nivel që ka qenë, me ata profesora që ka qenë, asnjoni prej nesh, prej Muslim Mulliqit e deri te unë ktu nuk do të ishim këta që jemi.

**Erëmirë Krasniqi:** As me vazhdu tutje me arsimim s'kishit mujt, masi qajo...

**Rexhep Ferri:** Ne ishim shku dika tjetër, ishim shku për kimi e fizikë, na kish hangër, diçka na kish hangër dikund. Dhe unë jam shumë mirënjohës atyne profesorëve që e kanë pasë atë kulturë dhe nuk ka qenë, nuk e kanë pasë egoizmin mu rujt për veti, por na kanë dasht' si vetveten edhe ne nxanësve edhe pse ishin shumica serb e malazez edhe ne shqiptarëve njësoj na kanë dasht'. Gjatë studimeve, se unë studimet figurative i marrë nga Peja, i nisi edhe deri te ky moment ktu që jom. Unë edhe tashti jom student edhe tash msoj. Deri sa jom në gjendje edhe jom i fortë për me çelë një libër me pa ose me një katalog një i ri si po pikturon, çka po pikturon, domethonë edhe prapë jom nifarë studenti që po mësoj diçka. Edhe do të doja që të ketë ma shumë provokime tek brezi i ri, për arsye se do të rinohesha edhe unë. Por brezi i ri, nuk e di si ta spjegoj tash punën e brezit të ri.

Gjatë kohës kur isha në Beograd, e merrsha një revistë të Ambasadës Amerikane "*Pregljed*" ka qenë, botohej në gjuhën serbo-kroate, një herë në muj dilte, ishte për kulturë dhe aty në atë gazetë ishte një intervistë me një piktor amerikan, një piktor i ri i cili tekstualisht thotë, "Picasso i ka bo për 60 vjet, 70 vjet i ka bo 50 kryevepra ose 30 kryevepra, por unë jom duke mendu si me i bo për tri vjet 30 kryevepra". Shikoje, nuk e di se sa e han pazari këtë muhabet, por me çfarë motori ti mundesh, as në Hanë as kërkund nuk mundesh me shku për tri vjet mi bo 30 kryevepra, dhe ai seriozisht e kishte, ishte brezi i juv i ri.

Më duket si diçka e ngjajshme te brezi i tashëm ekziston. Ndoshta, ndoshta nga ajo se e keni kuptu jetën shumë ma shpejt, si diçka e mrekullushme, me një mijë shije edhe e kalushme, e meqenëse qenka e tillë duhet sa ma shpejt me shfrytzu në të gjitha mënyrat, në çdo pore. Nuk e di sa, na kemi qenë një brez shumë i përkushtum në profesionin tonë, pa frymën e materializmit, pa frymën e mashtrimit, por shumë të besushëm në atë që punojmë, por njeriu besimin në atë që punon e ka edhe nëse ka besim në vetveten. Pa pasë besim në vetveten ti s'mundesh me pasë besim edhe në punën tone. Kjo ishte ajo gjenerata e cila nuk do të doja të thom që ky mit të mbyllet me ne.

**Erëmirë Krasniqi:** Kur u kthyt prej Beogradit?

**Rexhep Ferri:** Urno?

**Erëmirë Krasniqi:** Kur u kthyt prej Beogradit? Në cilin vit definitivisht?

**Rexhep Ferri:** Jom kthy, jom kthy niherë nga Beogradi mas Parisit në '67-tën, më 1967 kom kry Akademinë, kom shku në Paris, jom kthy nga Parisi në Prishtinë, kom punu në "Rilindje" si redaktor artistik dy vjet. Merrsha pjesë edhe në Beograd se isha i pranum në Beograd në "Shoqatën e Artistëve Figurativ të Jugosllavisë", merrsha pjesë nëpër ekspozita. Jo vetëm unë edhe shokë tjerë, Muslimi e kta që ishin ktu. Mandej, kom shku në shkallën e tretë. Ata dy vjet që isha në "Rilindje", unë ende isha i padefinum, a me nejt në Prishtinë? A me shku në Paris? Por e gjeta një mesatare, shkova në shkallën e tretë në Beograd dhe u ktheva përsëri në Beograd dhe mrenda atyne dy vjetve që unë isha në Beograd por nuk isha qytetar i Beogradit, shkojsha për shembull një ditë, dy ditë andej por nuk isha tonë kohën.

U bo një ndryshim shumë i madh edhe në Beograd, u bë një ndryshim shumë i madh dhe shof se nuk jonë mo ato sjelljet e shoqeve dhe shokëve të mi, ku bie fjala një shoqe që, femrat janë shumë ma të kujdesshme, gjithmonë na bishin diçka. Bile një vjet kemi pasë kalu mrekullueshëm. Gruaja e një Ambasadorit të Irakut, a Iranit a nuk di të kthynë shteteve e bijshin me veturë. Vetura e parë që u nalte para Akademisë ishte ajo dhe ajo na binte një tegëll me xhem a diçka. Shpejt shkojshim në furrë aty e blejshim ka një cop bukë e hajshim qaty, mëngjesin na heke ajo. Kështu që...

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ndryshoi sjellja?

**Rexhep Ferri:** Dhe... po ta ilustroj një ndryshim. Ka qenë një beogradase një vajzë, një shoqe e klasës e qujshim Pegi, se e ka pasë fytyrën me pika (qesh) edhe "Hajde", thojke, "Ferri shkojmë ta pijmë nga një raki të nxehtë në kafe" dhe para se me hi në kafe ajo mi jepte paret mu se dojke me i tregu atij se jom t'u hi me një gjentëlleman, s'jom t'u hi me një fakir që s'ka pare dhe nuk hike vetëm ajo. Ajo dojke me shku, por nuk dojke me shku vetëm. Mas dy vjete, për dy vjet u bo një ndryshim, me thonë një emancipim, nuk ishte emancipim, osht' diçka përtej emancipimit. E çka ka përtej emancipimit? Ndoshta osht' një pikë e një vizë e prapë një pikë.

E gjeta një Akademi me një liri, hike kush dojke, shkojke kush dojke, bojke kush dojke. Por edhe nuk ishte ai përkushtimi i përparshëm. Nuk ishte ai përkushtimi i përparshëm për arsye se, këtë ma ka thonë profesori im kur kom shku në shkallën e tretë, tha, "A po kujton që jonë ata?" Jo masi që e kom kry shkallën e tretë, u takova me ato se u bona profesor këtu, "Si p'e çon me studenta?" Po më pyt. Tha, "A po mendon që edhe unë i kom studentat qysh keni qenë ju? Ka ndryshu puna".

Kështu që, me ndryshu puna për t'mirë osht' mirë, por dy herë osht' ma keq për ata popuj që vonë e kanë kap hapin e formimit të personalitetit kombëtar, ngritjes kulturore, prezentimit kulturor. Se ka popuj qe historinë e vet e kanë fut në sirtar edhe në muze dhe ne kishim nevojë me thonë se e kishim kry shkollën, ne kishim nevojë të prezentoheshim.

**Erëmirë Krasniqi:** E qysh ju afektojshin juve këto hapat e shpejtë?

**Rexhep Ferri:** Te ne kanë ardhë ma ngadale dhe në atë kohë sinqerisht me thonë, e thom jo me naj kështu qëllim kritik, por Kosova ka qenë e njohur në arenën krejt Jugosllave, shtetin Jugosllav që i ka

pasë 22 milion deri në Lublanë edhe në ekspozitat Jugosllave përjashta që prezentohej Jugosllavia, artet pamore kanë qenë arti i vetëm i njohur në Jugosllavi, ma përpara se letërsia, se muzika, filmi...

**Erëmirë Krasniqi:** Vonë ja ka nisë.

**Rexhep Ferri:** Vonë, megjithëse kishte edhe në këto lami, kishte disa prurje të mira. Bjen fjala në muzikë ishte në atë kohë Rexho Mulliqi, burri i Nexhmije Pagarushës, që ai e ngriti Nexhmije Pagarushën, ai ka qenë një gjeni, një kompozitor fatkeq që nuk e realizoi veten sa duhet, por ka qenë një njeri gjenial. Ka qenë Muharrem Qena për dramë. “Erveheja” e tij që, ajo i murr të gjitha shpërblimet në Beograd. Fillun edhe kto, jo vetëm artet pamore, por fillun edhe...

**Erëmirë Krasniqi:** Artet dramatike.

**Rexhep Ferri:** Unë kom qenë në një koncert kur Nexhmija në Beograd, unë isha student, ka qenë plot salla, plot salla ka qenë. Unë kom shku se kisha miqësi me të, por edhe për, puna e gjakut është diçka e çuditshme, diçka që edhe e mirë është. Shkojsha edhe për hir që është shqiptare edhe u mburrsha me të. Bekim Fehmiun me pa tu lujt, dhe ne Bekim Fehmiun shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët në përgjithësi i kemi shumë borxh. I kemi borxh për arsye se me profesionalizmin tonë dhe me egon tonë që unë po bona, nuk po i ndihmoj se po du unë nuk e kemi kërkund në asnjë film tonin, në asnjë fjali në filmin shqiptar nuk ekziston Bekim Fehmiu, me fajin tonë edhe pse ai nuk ka qenë njeri i kalkulimeve, nuk lshojke pe. Por njerëz që janë jo të dashurum në personalitetin e vet, por janë të përkushtum në personalitetin e vet, ata nuk dorëzohen, ata nuk t’lutin, për asgjë nuk lusin. Ata duhet me i marrë me t’mirë si nana që e merr fmiun edhe osht’ një minus shumë i madh.

Mu m’kujtohet me një ekspozitë timen në Beograd, me qenë se jemi t’u fol për Bekim Fehmiun, në një ekspozitë timen në Beograd unë shkova në hapje dhe kur shkova në hapje të nesrit po kalon Ali Shukriu edhe p’e sheh, se ishte në “Pallat Albania” ka qenë aty Galeria e Qendrës Kulturore edhe ishte ajo përjashta reklama. Po hyn një funksionar i lartë, mos t’ja përmendi emrin se s’vlen edhe me permend edhe po më thotë pse nuk i kom çu thirrje në hapje. Unë po i kërkoj falje se unë kom ardh me tren edhe ku i kanë çu kta thirrjet nuk e di. Ishin msu me këta piktorët tjerë që ju çojshin, por unë nuk i kisha ato raporte me ta fort t’lidhuna, por as të prishtuna. Ishte edhe Bekimi e me Bekimin po rrijmë.

Tash po na thërret ai të nesrit n’shpi me shku me pi *wisky* me to. Bekimi po i kërkon falje, tha, “Kërkoj falje por,” se nuk e kishte n’qef as Bekimi, s’du me përmend se pos nja dy vetë tjerë kanë qenë, nuk muj me thonë që kanë bo naj punë t’poshtër kombëtare, kanë bo naj dredhi kombëtare për kta tjerët, por për nja dy, njani prej tyne ishte qiky. Bekimi po i lyp falje dhe tha, “Unë kom me shku në Itali”, lunte Odiseun, Uliksin. Nejse edhe ai shkoi, “Hajde”, tha, “Rexhep, hiqju atij çenefi” (buzëqesh) tha, “Ta qet Bekimi nji *wisky*. Tash dalim e pijmë një *wisky*, çka kena me shku te ai, hiqju tij”. Edhe ishte e vërtetë edhe përfundoi qashtu ai.

Shumica atëherë e njerëzve që kanë qenë në funksion janë mundu, ka qenë kohë shumë e vështirë, janë mundu me rujt këtë popullin e vet, popullin shqiptar, janë mundu me rujt edhe personalitetin e

vet, mos me rrshit. S’du me përmend emra, por kanë qenë nja dy, dy a tre të cilët nga egoja e vet për karrierë u bonë ma katolik se Papa.

**Erëmirë Krasniqi:** A ka pasë interferime të politikës në art? Ju i përmendët pak për letërsi.

**Rexhep Ferri:** Në pikturë nuk ka pasë, në muzikë [nuk ka pasë], se muzika për nga natyra vet osht’ abstrakte. Edhe ata që e studiojshin albanologjinë edhe që u merrshin me letërsi, prind ju thojshin, “A po don Fakultetin e Burgut me shku me studiu?” Kështu ka qenë në popull e përhapun ajo kohë, ashtu.

**Erëmirë Krasniqi:** E skanojshin gjithçka që u prodhojke, u publikojke? Po mendoj a ka pasë njerëz specialist që i kanë lexu mos ka naj subtekst. Çka ka ndodhë?

**Rexhep Ferri:** Po shife, njeriu i dishëm, që din, ai nuk gabon. Unë e kom pasë një punëtor kur bojsha shpi edhe po i thotë ai mjeshtri atij punëtorit, “O Halim, he dinamit”, ai po e çel temelin me tetarrkom, *e bam e bam* {i çon duart poshtë dhe lart}. Unë e kom pasë futë këtë figurë në poezi ma kanë hek.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u interpretu?

**Rexhep Ferri:** Se nuk e kanë interpretu njerëzit e dijshtëm por njerëzit e padijshtëm edhe “Dinamitin po e lyp Rexhepi”, sikurse te kjo kanga e Ilir Shaqirit që dheun, atëdheun, çka lyp ai diçka.

**Erëmirë Krasniqi:** A kthema borxhin (qesh).

**Rexhep Ferri:** Kthema borxhin diçka, a diçka qashtu, në Shqipëri kanë thonë, “Po çfarë borxhi more i kemi ne atij”.

**Erëmirë Krasniqi:** Po. (qesh)

**Rexhep Ferri:** Kështu që, ishte një kohë kur... tash po e lomë Beogradin edhe pse unë si të gjithë ne që rininë, pjesën ma të mirë të moshës sonë, vitet ma t’mira i kemi kalu atje, me gjithë ato vështirësi që i kemi pasë, e që mund t’i ketë një student i përkushtum. Ne jemi dashtë me qenë të përkushtum se ndryshe s’e hante pazari. Prapë se prapë ato janë vitet më të mira, sado që ti kesh të vështira {bën me dorë nga intervistuesja}, këto janë vitet e tua ma të mira.

**Erëmirë Krasniqi:** (qesh)

**Rexhep Ferri:** Në Prishtinë, sa fillum ne me marrë kamtë, me ecë në kamtë tona edhe tu ju falenderu qatyne udhëheqsave tanë komunist, jo neo-komunist se ata janë ma t’kqi, që i kemi edhe tash edhe në Tiranë edhe në Prishtinë neo-komunistat, që bojnë be në kry në Leninit, e Stalinit, e të Enver Hoxhës. Po e lamë politikën se, s’ja kemi pa kurrë hajrin për qato edhe po e lojmë.



**Erëmirë Krasniqi:** Por ka pasë ndihmes prej sistemit socialist për me kriju infrastrukturë kulturore a po?

**Rexhep Ferri:** Por, ndjenja e udhëheqve tanë që të jemi të barabartë me Republikat tjera Jugosllave i ndihmoj kulturës shqiptare. Në zyre kur shkojshe nëpër këto qendrat tjera i shihshe piktorët ma t’mirë të atyne, në Beograd të serbve, në Kroaci të kroatve, në Slloveni të sllovenëve dhe fillun edhe kta mos t’i marrin pikturat e çobanve t’vet, e djemve t’vet, e tezeve t’veta, por t’i marrin pikturat e... sot në asnjë zyre nuk e ke dikund një pikturë të Muslim Mulliqit. Po e marrë si shembull vetëm Muslimin, fillun të blejnë piktura, fillun të blehen piktura për Muzeun e Artit Modern, se t’gjitha Republikat kishin Muze të Artit Modern e ne s’kishim Muze Modern.

## Pjesa e Pestë

**Rexhep Ferri:** Kthimi im mandej në Prishtinë, unë i gjeta ktu Muslimin [Mulliqi] e Gjeloshin [Gjokaj], u kthym Tahiri [Emra], unë, Xhevdet Xhafa, Shemsedini [Kasapolli] u kthy nga Beogradi, Mateu, Fatmir Krypa e shumë e shumë tjerë. Mos t’him me bo tash ktu seleksionimin edhe listën e gjatë, por një brez i cili me përkushtim shumë sakrifikus edhe me personalitet e ka zhvillu rrugën e vet prijueve në atë kohë, e ka fillu edhe e ka vazhdu me shumë seriozitet. U kriju edhe një klimë ktu, u kriju edhe një vetëdije. Vijshin njerëz ose blejshin libra njerz edhe pse nuk i lexojshin, “I lexon dikush n’shpi”. Ktina mund t’i thuni, “Jo ky osht’ snobist”, por snobistat jonë shumë të dobishëm për kulturën, se investojnë në kulturë, e t’u investu në kulturë ju kthehet, në njërin nga tre brezat ju kthehet, ose te ai, ose te djali, ose te nipi, ose te stërnipi, kthehet ajo. Se rritet me...

**Erëmirë Krasniqi:** Libra...

**Rexhep Ferri:** Rritet me rrezatimin e asaj që e ka sjellë ai në shpi. Kështu që, ne atëherë bojshim shumë debate për kulturë, për art e...

**Erëmirë Krasniqi:** Çfare ishin? Çka ishin pytjet që i trajtojshit? Çka ju preokupojke në atë kohë?

**Rexhep Ferri:** Po, ishte një shkëputje me të kaluarën, që ishte një *aksham*<sup>11</sup> shkollë. Një kangë vetëm me dy nota, ose pa nota hiç. “Jo unë po kom qef me pikturu”, e pa investu në pikturë kurgjo hiç, veç “Valla unë e du pikturën”, por edhe unë du mi pasë krahët e engjullit e me fluturu. U kriju politika kur unë u ktheva ktu në Prishtinë në Shkollën e Lartë, filloi edhe politika edhe Kosova ta krijon një pavarësi ma të madhe e një shkëputje nga Serbia. Filloi u hap për herë të dytë, se u konë mbyll Instituti Albanologjik, Shkolla e Lartë nguli kambë për me u hap Universiteti, u hap Universiteti me shumë përkushtime.

Mu m’kujtohet çka ka bo ai brez për me hap Universitetin, pa mëditje, pa... si tash kta që çdo gjo e shofin përmes parasë. Natyrisht edhe politika na ka ndihmu atëherë, qata njerëz që kanë qenë, mos t’i

<sup>11</sup>Turq.: *akşam*, mbrëmje.

përmendim se jonë... Ende njerëzit mendojnë që krejt çka osht' nga Beogradi, krejt çka kemi msu atje duhet me i harru se ktu. E ktu kush? Na i msum, por ata nuk po e kanë guximin me e shpreh se unë kam msu nga Rexhep Ferri, por po thotë, "Unë i shkollës së Prishtinës e kom ngrit Universitetin në kambët e veta".

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh ju ndihmoj qajo garniturë shtetore shqipare që kanë qenë në atë kohë?

**Rexhep Ferri:** Qysh?

**Erëmirë Krasniqi:** Qajo garnitura politike që ka qenë tu e udhëheq Kosovën në atë kohë, qysh ndihmoi me u themelu Universitetin?

**Rexhep Ferri:** Shife, tu ju falenderu edhe përkrahjes së Titos. Tito nuk e ka ditë një herë se a ka Kosovë dhe çka o Kosova, për arsye se ka qenë shumë i rrethum nga politika serbe që mos me kuptu dhe vonë. Shumë vonë kur filloi edhe të ngjallet nacionalizmi serb, kur republikat tjera ta vërejnë këtë dhe të fillon një heshtje, një mosbesim atëherë Tito ju dha të drejtë Republikave. Në të njejtën kohë, na dha të drejtë edhe ne në Kosovë dhe atëherë u hap edhe Universiteti edhe të gjitha.

Unë e mbaj mend "Rilindja" botohej një herë në dy javë, një herë në dhjetë ditë, mandej u bo e përditshme, e vetmja gazetë që ishte. U hap Televizioni, Teatri murr kambë, Lidhja e Shkrimtarëve filloi të prezentohej, ne filluam të prezentohej. Në të gjitha ekspozitat që i hapte Jugosllavia nëpër botë, kishte edhe nga Kosova, ishim edhe ne prezent. Ishte fondi që Ministria e Kulturës e kishte të caktum atëherë, flas për vitet e '70-ta, për blerjen e çdo, për blerjen e pikturave për fondin e Muzeut të Artit Modern dhe sot ato piktura i kemi në podrumin e Galerisë. Ka njëzet vjet, tridhjetë vjet mas çlirimit, vetëm nëse kanë ble naj pikturë të naj mikut të vet kështu, se unë po du prezentimin me ma qit aty.

**Erëmirë Krasniqi:** Kryesisht s'ka pasë buxhet, mbështetje për artistët.

**Rexhep Ferri:** Por atëherë, atëherë ka pasë buxhet. Tash a nuk paska buxhet a?

**Erëmirë Krasniqi:** Tash nuk po flasin mo për...

**Rexhep Ferri:** A din se për herë të parë mas tridhjetë vjete kom ndëgju që dy njerëz që thanë Muzeun e Artit Modern, e përmendi kjo ministrja e re e kulturës Vlora Dumoshi, që tha kjo ndërtesa...

**Erëmirë Krasniqi:** E Gërmisë?

**Rexhep Ferri:** E mallrave, Gërmia, ajo përballë Teatrit e mirë për Muze të Artit Modern edhe tash Kryeministri Kurti që e tha në fjalimin e vet, "Duhet të bohet Muzeu i Luftës, duhet të bohet Muzeu i Artit Modern". Tridhjetë vjet, as profesorat e Akademisë nuk e kanë përmend, as ju t'rinjtë s'e keni përmend, na pleq e kemi hangër pilafin. Prandaj, nganjëherë njeri çka ja bon vetit edhe armiku ma i madh s'mundet me ja bo.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kujtohet dita kur u hap Galeria e Arteve në Boro Ramiz?

**Rexhep Ferri:** Po, po.

**Erëmirë Krasniqi:** Ju keni qenë pjesë e ekspozitës.

**Rexhep Ferri:** Kur u hapë Galeria e Arteve, [Pajazit Nushi](#) ka qenë...

**Erëmirë Krasniqi:** Kryesus i BVI-së të Kulturës.

**Rexhep Ferri:** Jo i kulturës, ka qenë nënkryetar qeverie, qeveria ka qenë diçka ka pasë një post dhe e hapën aty dhe mu nuk m'pëlqej ajo punë hiç.

**Erëmirë Krasniqi:** Pse, a mundesh me na spjegju?

**Rexhep Ferri:** Pse ajo ishte një dyqan pak i madh dhe nuk ishte institucion n'veti. Sado e keqe që të jetë Galeria [e stome], osht' institucion n'veti. Por e hapën. Në atë darkë isha edhe unë edhe unë isha i ri edhe isha pak ma i guximshëm me reagu a di, mi thonë dikujt, "S'osht' edhe për me livdu aq shumë", kështu ja pata thonë.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju pengojke që ka qenë...

**Rexhep Ferri:** E tha, "Na ende i kemi shkollat", ma boni Pajaziti mu, "Ende i kemi shkollat me shkomi".

**Erëmirë Krasniqi:** Me shkam, po.

**Rexhep Ferri:** Me shkombi. (qesh) Ama, ne ktu kemi qenë edhe kolegë, se ka qenë akademik edhe ai edhe unë edhe kemi qenë. Ka qenë burrë i mirë, po është e vërtetë se... jonë do gjana që njeri i bon edhe për inati, për me rujt trashëgiminë e vet, për me dyfishu, trefishu trashëgiminë e vet. Nëse trashëgiminë kulturore nëse nuk e dyfishon, trefishon ti je komb në prespektivë, se shumë gjana harrohen, shkëlqimet që janë të tepërta, që dalin jashta natyrës njerëzore edhe jashta natyrës t'përgjithshme.

A ka dritë ma t'mirë se drita natyrale? Nuk ka, osht' shumë e përshtatshme për portretin e juj {bën me dorë ngaintervistuesja}, por çka me bo ne jemi tash mes dritës natyrale dhe portretit t'juj, kemi ardh deri te drita artificiale dhe portreti i maskuar, e i maskuar, i krehun, i ç'krehun e i modeluar, i modeluar nga ndaq operacionet, ndaq beteret dhe mos me mujt me njoft. Kjo ndikon edhe në psikologjinë e jetës, ndikon edhe në përkushtimin. Si mundem unë me ja falë jetën veprave të mia e veprat e mia me i vjerr dikush mas dere për arsye se nuk i kupton, ose nuk janë të mira, ose se don me qit dikond të vetin, osht' ajo egoizmi.

Këto gjana kanë ndodhë edhe përpara gjatë historisë. Në Spanjë ka qenë i vetmi ndoshta El Greko, një grek që ndoshta ai ka lind në Spanjë që ja ka kushtu krejt jetën pikturës dhe dyqind vjet ka qenë i njohur, por jo edhe sa osht' tash i njohur. Spanjollët dojshin me pasë njerin e vet.

**Erëmirë Krasniqi:** A e kthej njëfarë lloj vetëbesimi kombëtar ose identitar fakti që u kriju qikjo shtresë e artistëve. Qikjo klasa e artistave kur u kthyt krejt prej Beogradit, a e përqendroi [skenën e artit] në njëfarë forme?

**Rexhep Ferri:** Shife, ne në atë kohë e kemi përjetu një renesancë ose një rilindje të dytë, jo ajo e kohës së Naim Frashërit a di, por për ne ka qenë një rilindje e dytë, dhe ajo lypte njerëz të fortë lypte, nuk lypte interesgj, nuk lypte tregtar, lypte personalitete dhe çdonjani prej atyne e kanë pasë personalitetin e vet pa interesa. Tash, nuk e di pse jemi alergjik ndaj atyne vlerave, pse nuk i njohim ato vlera. Nuk kemi ndëgju shumë sepse nuk kemi bo që me ndëgju. I kemi lonë me qëllim në harresë. Unë nuk muj me fol kundra studentëve, për arsye se rininë time ja u kom falë studentëve, kom qenë profesor i tyne edhe ju jeni të ri dhe e kuptoni ndoshta, se nuk e kom me qëllim të keq por nga inati, nga inati duhet ta thom me zo të ulët, jo për me ndëgju.

Hap një studente që s'ka kry studimet thotë, "E kom gjetë një stil të ri" dhe të gjitha gazetat tona, televizioni jonë thotë, "Ka gjetë një stil të ri". Nuk e kuptoj si mund ta lejojmë ne veten që disa kuratorë nga jashtë, jo nga brenda, na i kanë propozu krijuesit tani për Bienale, për secilin. Njoni nga ose njena nga Germania, tjetri nga Viena. A s'patëm na? Fatkeqësia ma e madhe është që ne e kemi lonë të na udhëheqin njerëzit që po u thom që jonë kuratorë. Ne kemi nevojë për menaxher, menaxher të cilët e plasojnë kulturën e një kombi dhe e reklamojnë, ja hypin vlerën me prezente.

**Erëmirë Krasniqi:** Çfarë ndodhte paralelisht përderisa u hap Galeria, u hap edhe Universiteti? Çka ndodhte? Po mendoj, ishte edhe Klubi i Artistëve, ka qenë edhe Shoqata...

**Rexhep Ferri:** Atëherë kanë qenë shoqatat shumë aktive dhe roli i tyre ka qenë jashtëzakonisht i madh dhe nuk vishin të huajt me na bo edhe kur merrshim pjesë në ekspozitat jugosllave nuk vijshin ata, mirëpo na vet e zgjedhshim kush me shku dhe në juri shkojshim. Por, nuk e di. Aq sa osht' një stagnim në kulturë {zgjatet përpara nga karrika} osht' edhe problemi se gjatë këtyre viteve erdh ndrrimi i shekullit, ndrrimi i gjeneratave, ndrrimi i besimeve, ndrrimi i koncepteve edhe për jetën edhe për artin edhe për të gjitha. Nuk po thom nga momenti kur njeriu, për njeriun vdiq Zoti, por nëse për njeriun ka vdek Zoti atëherë ka vdek për njeriun njeriu. Se njeriu ka nevojë për një mbështetje, por jo një mbështetje mos me msu me hec ai në kamtë e veta, por një mbështetje...

Ne kemi besu shumë që jemi një popull fisnorë edhe unë sinqerisht me thonë, ju e keni kuptu ndoshta shumë mirë edhe po e shihni, ne nuk kishim qenë bash qashtu popull qysh e lavdojmë veten në këngë popullore. Nuk i kemi njerëzit që i kishim, që j'u besojshim. Tash kemi fillu mos me besu as në vetvete dhe duke mos besu në vetvete vjen puna edhe zhgënjimi në profesion, nuk je mo i përkushtum shumë. Mundohesh sa ma shpejt me shit pazarin, sa ma shpejt me bo. Mundohesh me prezentu një vepër ende pa e kry, ende pa u terë një pikturë me e qit në ekspozitë, ende pa nejt ajo në atele e me fol me ty. A po fol, a s'po fol? Mikelanxhelo kur e ka bo "Davidin" i ka mshu në gju me çekiq, "Fol! Pse s'po

fol?” [citon Michelangelo-n] Dhe e ka shenjën me çekiç që i ka mshu. Si ta çoj unë një pikturë time hala të lagët në ekspozitë, hala pa e ditë a po folë a s’po folë, figurativisht po mendoj.

## Pjesa e Gjashtë

**Erëmirë Krasniqi:** Si ju priti viti ‘81?

**Rexhep Ferri:** Po viti ‘81 nuk fillon me ‘81. Shekulli i ri, domethënë nuk ka fillu me vitin 2000, por gjithmonë prin diçka përpara. Gjatë viteve të ‘70-ta kur unë kom qenë në shkallën e tretë ka fillu një frymë e re e post-modernes në art e në jetë. Domethonë, me ne po fillon çdo gjë dhe ne kemi qenë ata që... ne, vitet e ‘70-ta e knej që Kosova filloi me ecë me kambët e veta. Normalisht gjatë ecjes shpeshherë edhe rrxohet njeriu, rrxohen edhe muret, me kohë rrxohet edhe shumëçka. Ndoshta edhe nga... ne nuk kemi hecë shpejtë, por meqenëse kishim fjet 500 vjet...

**Erëmirë Krasniqi:** Ishin dramatike krejt këto [ndryshime]?

**Rexhep Ferri:** Mandej u mendojshim... osht’ diçka brenda njeriut që nuk e komandon mendja e njeriut, osht’ diçka tjetër që e komandon. Unë nuk jom naj njeri i shejtë që me ditë kush e komandon njeriun. Por, deshtëm e s’deshtëm s’dojshim me shpejtu hapin, por e shpejtum edhe hapin. Dojshim të jemi... sa ma parë të harrojmë primitivizmin tonë, vuajtjet tona, robërinë tonë, varfninë tonë dhe tu i harru ato ne i harrum edhe shumë gjana tjera që kanë qenë të shumëfishme. E harrum atë ngrohtësinë në mes njerëzve. Njerëzit kanë qenë shumë ma të varfun se që jonë tash, e shumë ma tepër e kanë dashtë njeni-tjetrin, sesa e donë sot. Këto ju nuk e di a e kuptoni, a s’e kuptoni se jeni brez i ri edhe nuk e di sa e keni mirë e sa s’e keni mirë kur po mendoni se me ju po fillon çdo gjë.

Kjo post-moderna që e përmenda, ajo osht’ thjeshtë një, një mohim i arsyeshëm për arsye se osht’ një fëmijë që s’po mundet me lind. Pse s’po mundet me lind? Se nuk e ka komoditetin. Shekulli i XX-të ka qenë një shekull i cili në enciklopeditë që i kemi për civilizimin në përgjithësi i ka shrytëzu të gjitha kohërat, të gjitha civilizimet dhe ka mrii prej një... Unë e di që bicikleta ka qenë në fillim edhe unë në Pejë gjatë viteve ‘50-ta kom shku prej Gjakove në Pejë në Shkollë të Mesme të Artit me një taksi me dru, e ka pasë një stufë përmapa, drutë e shkurtume i kishte në thasë nalt në gepek dhe ai shoferi, “Hajde, shtypini, musheni koftorin”, na *ra ba ba* {onomatope}. Bora ishte, e mushim koftorin, “Hajde a po nisem, po nisem” (buzëqesh). Katër orë bojke me shku në Pejë. Kjo osht’ viti kur unë kom qenë nrxanës në Pejë, viti ‘54-55-56, qaty dikund.

Tash nisen mes veti, “Pse ma ki nxon ti mu vijën time? Pse ma ki nxon vijën time?” Autobusa ka sa t’dush. Kështu që, mohimi nuk osht’ mirë kur osht’ i qëlimshëm me qëllim me harru. Por nëse ti gjenë një mundësi ku mundesh me fillu hapin tond me vazhdu nga një pikë që një brez e ka lonë. Por jo me qëllim tash u hapën kufitë edhe dulëm e pamë krejt. Në televizion çdo gjë ki tash.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka ke qajo që u mohu edhe a jemi tu dashtë me dal qaty që udhëtimi e ka pru njëfar revolte politike a?...

**Rexhep Ferri:** Shiqo, ndoshta ishte edhe kjo koha e re si ta quj unë, e cila osht' para një provimi shumë të madh edhe ta gjejnë veten edhe pa dyshim që do të mbetet diçka edhe nga ky shekull, se historia osht' e padhimshme, historia nuk është nanë. Na kemi shekuj e shekuj që s'dijmë kurgjo për to. Njëpër ata shekuj kanë jetu njerëz, njëpër ata shekuj kanë kriju diçka, por kemi mbri në një kohë ku në të njëjtin vend në Persi e Siri atje, ku ka lind shkrimi kujor. Pe din për çka e kom fjalën?

**Erëmirë Krasniqi:** Po, po.

**Rexhep Ferri:** Ato pllaka janë qeramikat e pjekune dhe janë njëpër muze dhe unë i kom pa njerëzit e tashit tu i shkel ato, tu i thy për me kqyr me vjedh diçka mos ka farë dukati, farë sendi. S'di a ... e shkelin të kalumën e vet. A e din ti që ajo pjesë, ne jemi tu bo mëkate shumë të mëdhaja. Ne kemi rruz përmendore, shtatore që kanë qenë fillimi i mendimit të njeriut, fillimi i civilizimit. Ndikimi i fesë, ndikimi i injorancës, njëfarë urrejtje kombëtare, njëfarë bizantizmi i zi.

**Erëmirë Krasniqi:** Si prioritet edhe kulturor njoni ndaj tjetrit. Por a mundemi mu kthy te '81-ta po më intereson qysh...

**Rexhep Ferri:** Te '81-ta unë, në '81-tën në kulturën tonë osht' bo një ndërprerje shumë e madhe për arsye se orientimet njerëzore jo që lypin motivacion, por ndrrun edhe kërkesat filozofike për jetën. I tham, "Rri pak se dojna me bo një punë tjetër". Unë osht' dashtë të hap me '81 një ekspozitë në Paris s'e kom hap, ekspozitën time të dytë edhe kurrë mo qe, mandej erdh lufta, mandej maslufta, mandej shumë punë, ndryshun edhe kërkesat.

**Erëmirë Krasniqi:** A ju kujtohet qajo ditë kur ka fillu protesta edhe pasiguria që e ka ndi stafi akademik shkaku i studentave?

**Rexhep Ferri:** Po shife, studentat tanë kanë qenë shumë të {pauzon dhe merr frymë}, shumë sakrifikus, me bindje sakrifikus. Unë i kom ndëgju studentat e mi tu i thonë njoni-tjetrit, "Mu s'më dhimet jeta sa kjo cigare e duhanit". Por atë student nuk ishte, nuk ishte student i kohës kur unë kom qenë student, se atëherë nuk mundte kush me mendu kur unë kom qenë student që mundesh me luftu me Serbinë, mundesh me luftu me Jugosllavinë e cila i ka 22 milion banorë. S'di a po... por ne me atë figuracionin tonë, figurativisht i kemi rritë ata studenta, i kemi eduku pa komplekse, se ishim vet të kompleksum dhe këtë nuk e thonë këta, nuk e thonë për arsye se erdhi koha e të gjitha shijeve tjera. Jeta i ka njëmijë shije. Si me ne po fillon dhe si ta harrojmë ne të kaluarën? Si ta harrojmë shekullin e XX-të? Se po na pengon shekulli i XX-të që në njëfarë mënyre osht' edhe pengesë, se shekulli i XX-të ka kriju, ka dhonë shumë njerëz gjenial.

Të gjitha shpikjet janë bo në shekullin e XX-të dhe nuk po ka vend për, duhet m'i hek gjysën për me mujt me i zbraz faqet (buzëqesh) me shti... por, unë ja u kisha bo një pyetje. Gjatë asaj kohe kanë qenë, kanë pasë, ka pasë mite, ka qenë një Picasso, ka qenë një Miró, para tij ka qenë një Van Gogh, para Van Goghut nga Holanda ka qenë një Rembrandt. Tash nuk e di a osht' koha t'u punu për krijimin e

personaliteteve të mëdha apo për uniforma që t’gjithë me qenë të bukur, të gjithë me qenë të veshun njësoj, të gjitha femrat me qenë të bukura. S’di a po më kupton. Ka fillu, shifi këto në televizion, tana e kanë si me qenë motra t’u bo operacione plastike.

**Erëmirë Krasniqi:** Po ato janë standarde që shtyhen prej institucioneve të mediave, po mendoj...

**Rexhep Ferri:** A e din mediat, tash po i përmend mediat, por a e din çka ka qenë media. Në medie ti nuk ki mujt me qit artikull që ka shku në dom të personalitetit të njeriut, që ka qenë kundra kombit tond, të asaj gazete. Tash ma shumë ki të palara se të lara nëpër mediat tona.

**Erëmirë Krasniqi:** Ka ndrru edhe statusi i mediave se tash janë ma shumë trajtohen si biznes. Deshta me ju vetë për diçka. A ju kujtohet dita kur jeni dashtë me braktisë me dhunë në fakt Universitetin e Prishtinës? Qysh ka ndodhë qajo ditë në ‘89, ‘90, ‘91, qikjo ditë e... Se ju e keni themelu, po më intereson qajo prespektivë prej anës të juj. Qysh ka qenë qajo ditë kur ju, krejt stafi akademik i Akademisë të Arteve nuk ka pasë mo qasje në institucione. Qysh jeni organizu?

**Rexhep Ferri:** Shife, njeriu sa do të jetë i shkollum dhe i dijshtëm nuk mundet me qenë edhe aq shumë largpamës. Ne kur na kanë qit prej pune, mu m’kanë qit prej pune kur e kanë qit para meje Muslimin edhe m’i prunën m’u studentat e Muslimit edhe unë nuk i mora dhe m’qiten edhe mu. Ata veç e kishin plan, pritshin...

**Erëmirë Krasniqi:** Një arsyetim.

**Rexhep Ferri:** Po, dhe na majshin mbyllë në një dhomë, në një zyre sa kjo {bën me duar rreth zyres} ku nuk vinte një serb që ka qenë, mos t’i përmendi emrat tash, se i vike marre prej Muslimit se i kish’ ndihmu Muslimi shumë.

**Erëmirë Krasniqi:** Karalejić?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo Arsić ka qenë, po nejse. Vike një boshnjak i Rozhajës, i cili kur i ka vdek baba, na kemi shku në shpi ja kemi pa fotografinë e babës e të gjyshit me veshje kombëtare shqiptare dhe kurrë s’kemi ditë se ai din një fjalë shqip. Ai vike me nejt me ne. Vike me nejt me ne ma tepër në mënyrë provokative dhe Muslimi ka qenë shumë inteligjent dhe p’e kupton dhe ka qenë i guximshëm, por e dike edhe masën e guximit. Po i thotë, “Ti je Rusofil”, nuk po i thotë serbofil, nuk po guxon, por po i thotë rusofil dhe ai e kuptoi dhe u çu në kambë edhe po flet serbisht. Tha, “Unë jom”, se ai serbisht folke, nuk folke shqip, kurrë s’e kom ni, veç atë ditë e kom ni shqip nja dy fjalë dhe tha, “Unë jom ma shqiptar se ju. Jom me fis Kelmend” dhe e çoi dorën {ngirt dorën} edhe Himnin e Flamurit. Në atë kohë Himnin e Flamurit nuk e dishim ne, se nëpër nevojtoret tona, ne e dimë qysh jonë nevojtoret e kohës, tash janë më të mira, përpara të shkollave me bo “KR” me gjetë të shkrome dikund, vike Komiteti edhe bojke kërdi, “Kosova Republikë”. Ky me të madhe Himnin e Flamurin shqip, *bam, bam, bam* {onomatope} e thej derën edhe dul përjashta.

**Erëmirë Krasniqi:** E çka ke kjo, me fitu besimin e juj?

**Rexhep Ferri:** Hë?

**Erëmirë Krasniqi:** Për çka e boni? Me fitu besimin e juj apo?...

**Rexhep Ferri:** Jo, jo, nga urrejtja, nga mllefi që i tha, “Ti je Rusofil” dhe Muslimi tha, “Rexhep a e din Himnin e Flamurit?” Thashë, “Jo. E ti Muslim?” Tha, “As unë”, tha “E ky biri i qenit po e dika për ne. Po ku e ka msu?” Nuk po i shkon mendja, por mu m’shkoj mendja se baba im kishte ardh qashtu, me çelë shkollën shqipe në Plavë gjatë kohës së Italisë, që quhej “Koha e Shqipërisë” atëherë. Thashë, “Muslim ky tri vjet ma i vjetër se ti dhe në Rozhajë. Ky i ka kry dy klasë në gjuhën shqipe dhe atëherë ka qenë urdhni që çdo ditë në çdo klasë, në orën e parë të mësimit, ora e parë e mësimit me fillu me Himnin e Flamurit dhe ky dy vjet e ka pasë obligim dhe s’e ka harru” (qesh). Kështu që, kanë qenë momente shumë të vështira, shumë të vështira.

Studentët tanë i fshiu edhe një eufori, na tash ende nuk është koha me fol, ende kërkush kjartë nuk e thotë se kush e nisi. {Ndalet, pauzon} Të gjitha grupet i kanë nxonë me parolla, “Marksizëm, Leninizëm” dhe i kanë nxonë mas tri dite, mas një jave, mas një muje. Por, në çdo, te çdo brez dhe në çdo kohë rinia është revolucionare dhe rinisë ma pak ju dhimet jeta edhe pse osht’ i ri, sesa kur ma vonë pjeket e bohet pak plak, atëherë fillon me ju dhimtë jeta. Sikur tash studentat e mi, “S’më dhimet jeta si qikjo cigare e duhanit” a mu m’u dhimte. Por, ishte edhe një fat i mirë që ne fillum ato demonstrata që nuk i kuptojshim edhe fort mirë.

**Erëmirë Krasniqi:** Për Universitetin në të ‘90-tat po flisni?

**Rexhep Ferri:** Po flasim për ‘81-shin. Nuk i kuptojshim se njeriu nuk mundet me shku ma larg sesa shkon drita, se mandej nuk din se ku je. Por, koha është mrekulli. U bo zhbërja e Jugosllavisë, u bonë krimet e mëdhaja mes kroatëve dhe serbëve, serbëve dhe boshnjakëve, Vukovari, Reçaku, ai tjetri, jo Jasharajt, familja Jasharaj. Kështu që, bota për me pshtu fytyrën e vet na ndihmoi dhe na ishim të përgatitun me ato çka kishim dhe ma tepër me trupat tanë dhe u mbyll ky kapitull.

**Erëmirë Krasniqi:** Qysh u organizu Universiteti nëpër shpia a mundesh me na tregu?

**Rexhep Ferri:** Universiteti nëpër shpia ka hecë në dy binarë. Një binarë që njerëzit kanë nxjerrë përfitime, në binarin tjetër që njerëzit kanë shkrefu çdo gja. Në rrugën time merrke 300 euro qira, 300 marka qira!! Që ne merrshin 20 marka rrogë, ose dhjetë marka rrogë që na vishin kishe nga diaspora dhe tjetri mos të thom unë, jo që s’merrsha kurgjo hiç, por menxi me nxemje, me rrymë, me krejt ishin në shtëpinë time dhe në fund na dhanë nga një copë letër si mu, si Shabanit. Shabani që i merrke ka 300 euro, marka edhe Rexhepi që s’merrke kurgjo hiç edhe sinqerisht me thonë s’e kom rujt. Çka kom pasë me rujt?

**Erëmirë Krasniqi:** Me ja jep Shabanit, ki mujt Shabanit me ja jep. (qesh) Po boj hajgare.

**Rexhep Ferri:** Po edhe besa nuk ka qenë Shabani por dikush tjetër, por ne jse e hangër tash ai e thashë. Ka qenë një tjetër një kojshi i Shabanit (buzëqesh). Kështu ka ndodhë edhe në krejt...



**Erëmirë Krasniqi:** A vishin studentat te ju edhe pikturojshin a qysh e organizojshin orën?

**Rexhep Ferri:** Po ka qenë, unë, më kujtohet ka qenë ai entuziazëm shumë i madh. Unë në katin e tretë e prisha një mur se andej mendojsha me lonë pesë me pesë në kulm njëfarë si çardaku<sup>12</sup> edhe ishte e murosun ajo, por nuk ish' e lyme, knej ish' e lyme. Edhe e prisha murin edhe u bo ajo klasa e madhe. Tash anej shihej drita që s'ishte e lyme, i mora niparë perde të gruas që i kishte ajo si të vjetra e ja qita aty e u bo mirë ajo punë. Më ka ndodhë mandej do vajza, se vajzat janë shumë të ndjeshme e të mira, për naj punë me korigju temën e magjistraturës, kur erdhi ajo asistente që e pata marrë, "O sa mirë ka qenë ktu". Po çfarë miri, drita... (qesh). Në ato vështirësi ju dukshin që ka qenë mirë. Shpresa është shumë një gja e madhe, shpresojshim që do shpërthejmë e do të bohet mirë edhe më vjen keq që u bonë njëzetë vjet edhe nuk u bo bash mirë, nuk u bo bash mirë se juve po ju shkon jeta, nuk u bo bash mirë se... Unë e marrë çdo ditë taksin edhe më thotë taksisti, "Profesor, 15 mrena qityne dy jave prej taksistave kanë shku në Gjermani".

## Pjesa e Shtatë

**Erëmirë Krasniqi:** A mundem me u kthy te diçka personale. A e keni pa ju babën e ju?

**Rexhep Ferri:** Babën tim e kom pa tri herë pas moshës shtatë vjeçare që m'ka lonë. E kom pa me katër të katërtit [4 prill] që e përmenda unë, dikun me '74 ose '75, 1975 kur shkova se isha si profesor.

**Erëmirë Krasniqi:** Shkëmbimet kulturore mes Shqipërisë dhe Kosovës?

**Rexhep Ferri:** Po, po, kur shkova edhe e kom pa. Mandej e kom pa mas nja një vjeti, dy vjete. Tri herë, por ishte plakë atëherë edhe vdiq. As që kom mujt me shku në vorrimin e tij se s'na lejshin me shku. Çka me bo.

**Erëmirë Krasniqi:** E vllau kur u kthy?

**Rexhep Ferri:** Vllau nuk osht' kthy. Vllau u smu nga kanceri edhe tri vjet mas vdekjes së babës vdiq edhe vllau, ka lonë atje mesat. Nostalgjia është shumë e çuditshme, por edhe njeriun e mban gjallë. Ndoshta edhe e han nga pak si smundje. Ai e ka dashtë shumë Kosovën, vllau, ma i ri se unë ka vdek e njëzetë a tridhjetë vjet. Vdiq me mallë nga Kosova. Kur erdh çika e vet thojke, "Baba na folte për Gjakovën si për Parisin, e ajo si Lushnja". Mirëpo, tash këto ndryshimet që jonë t'u ndodh në kulturën tonë, në jetën tonë të përditshme, në moralin tonë edhe politik edhe ekonomik ose si familjar. Jemi në një, kemi shumë dilema përpara, unë kom ma pak se e kom kalu jetën, por ju jeni para shumë dilemave. {pauzon} Çka do të bohet?

**Erëmirë Krasniqi:** Po du me përmbyll me diçka ma personale. Jakupi m'tha që e keni një tregim për një kali kur keni qenë i ri, tha është tregim shumë i mirë, ndoshta kish' qenë mirë me dokumentu.

<sup>12</sup> Çardak: Pjesë e haur, e rrethuar zakonisht me parmakë dhe e shtruar me dërrasa, në katin e dytë të shtëpive të vjetra, që shërbente për të pritur miq ose për të ndenjtur në verë.

[citon Jakup Ferrin] “Pyte babën për një kali që e ka pasë si fmi. Qysh ka shku me punu me kali edhe ndoshta të intereson si tregim”. A kishit mujt me na kallxu për këtë pjesë? Për çka e ka fjalën?

**Rexhep Ferri:** Leji hiçju Jakupit. (buzëqesh)

**Erëmirë Krasniqi:** (Qesh)

**Rexhep Ferri:** Shiqo, unë kom kalu, unë i kom një parë këpucë që kanë qenë atëherë në modë të Italisë, që m’i ka ble baba kur i kom pasë tri vjet, dy vjet, hala i kom, te librat i ruju. I ka fotografu Jakupi ato. Mandej, kur na kanë konfisku krejt pasurinë mas luftës, ne kemi qenë familje e varfun shumë {pauzon}, një kohë të shkurt e kemi majt një kali për me mujt me kalu atë rrugën për me shku te tezja, ishin nja dhjetë kilometra prej Gjakovës që ikëm, nga SUP-i që na kontrollojshin, i thojshin nanës, “Ku e ki burrin?” Bile ma mirë po ja u tregoj një detal tjetër.

Nana i ka pasë nja njëzet flori të cilët ja ka pasë falë vjehri, vjehrra, kunati, nana e vet, axha, knej andej dhe qato i ka pasë edhe burri çka i ka ble dhe pos asaj punës që bonte vet me vek. Kur vinte vjeshta, ajo i thente dy lira, dy flori dhe blente miellin, pasulin, lakna, drutë, kto ato, gjanat kryesore dhe atëherë mendojshim që dulem në verë. Por një ditë po vijnë, po e thërrasin nanën në Seksionin e Punëve të Brendshme dhe ajo më merr mu me veti, unë i vogël. Se ishte e re ajo dhe shkum ne. Ka qenë Llaza të cilën kom ndëgju ma vonë që shqiptarët e kishin pasë pshtu prej gjermanve dhe po i thotë nanës. “Çka e ki kto?” “Djalë”. “Sa fmi i ki?” Po thotë, “Pesë”, pe din ai për babën që nuk osht’. Tha, “Mirë po jeton ti, po ki flori po i mban”, kjo po hesht. Po thotë [ai], “Po, po, e kom njeriun ktu që ja ki shit dhjetë”.

Ajo menjëherë e kuptoi, nana ime s’ka pasë shkollë, baba ime ka pasë shkollë, por ka qenë shumë inteligjente. Jo vetëm ajo, por krejt ai brez kanë qenë shumë inteligjent e pa shkollë, për arsye se janë detyru që mos me mbajt mend që e shkrova e mendja ka punu ma shumë. E kuptoj ajo, tha, “Jo dhjetë po dy”. Ai po thotë, “Jo dy, por dhjetë. E kom njerin ktu unë”, “Bima njerin”, tha “Bjere” edhe e pru dhe “A pe ngjeh këtë gru?” Tha, “Po”. “Sa flori t’i ka shitë kjo?” Tha “Dhjetë”. Nana si tash m’kujtohet, isha i vogël, por njeriu ngjarjet e fëmijërisë kur janë të rralla s’i harron kurrë. E harroj se ku osht’, në zyrën e kujt osht’, e shefit të Punëve të Brendshme në çfarë kohë atëherë, tash o kollaj.

Po i kthehet atij njerit, “Jo dhjetë po dy t’i kom shitë”. Ai, “Jo dy, por dhjetë”. Tha, “Phu Zoti t’marroftë, qysh s’po t’vjen marre prej musteqeve me rrejt”. Kur Llaza po thotë, “Kapne këtë bërlllog qitne përjashta”, tha “e ki gjetë një gru me ngarku te dallaverxhitë tu me i mbrojt. Kapeni çojeni poshtë”. Për nder i tha nanës mandej, “Shife, meqenëse je ka i rrit fmitë, prej meje e ki lejen ka dy, nuk e di sa i ki (qesh), por nëse ke, por prej meje i ke nga dy mijë me i rrit fëmijët. Ma mirë me i rrit se me i lonë rrugave me u bo rrugaq”.

Kështu që, fëmijëria ime ka shumë peripeti, por në fund mund ta mbylli se jeta ime edhe mendoj se kom pasë fat në jetë. Kom pasë fat në jetë për arsye se shumë gjana i kom realizu. Nuk e vras mendjen sa e kom realizu veten si krijues.

**Erëmirë Krasniqi:** A kishit mujt pak me fol, dje që folem për motivet shqiptare brenda ngjyrës moderne vizuele. A kishit mujt edhe këtë pjesë para se me përmbyll intervistën. Qysh osht' zhvillu arti? Cilat janë temat?

**Rexhep Ferri:** Shife, unë kom qenë pak ma abstrakt, por ishte edhe koha kur abstrakcioni ishte ma në top listë. Isha edhe ma abstrakt edhe për një arsye tjetër, se nuk dojsa me i ngja kërkujna, mos me prek andej, mos me prek knej edhe piktura ishte ma, ma me pak... Sa ma shumë njeri që të punon e gjen vijën e vet dhe sidomos mas tapicerive kom fillu, por mas 50 vjete kom fillu një cikël të ri të pikturave mas tapicerive, sepse tapiceritë janë si të gjitha teknikat tjera të pikturës murale të artit monumental. Domethonë materializimi i veprës, më shndërru në një material. Këpucët kanë qenë lëkurë e një bizoni ose në kau e jonë këpucë tash. Mas tapicerive ose gjatë tapicerive osht' deshtë, se unë e kom studiu pikturën monumentale.

Mas tapicerive ose për mi bo tapiceritë unë osht' deshtë mii fut në sistem pikturat e mia të leximit, në matematikë, dy edhe dy bojnë katër dhe tu i fut ato dhe tu e ditë se kom me bo edhe mozaiqe, tu e ditë se tash nuk osht' ngjyrë por osht' guri me ngjyrë edhe qysh duhet mi rradhit gurët, qysh duhet ata gurë me u ngjit njoni me tjetrin. Me i ngjit atëherë s'ka pasë nevojë me qenë dy, po njo dhe çka osht' ajo në mes të gurit, fuga. Ku është sharmi i mozaikut?

Fuga është, renditja e vijës, gurëve të tjetër ngjyre qysh shkon ajo edhe fuga mes gurëve e cila është frymëmarrja, mushkритë e saj. Ashtu osht' edhe në afreskë, ashtu osht' edhe në tapiceri dhe masi i krevia edhe u lodha pak, atëherë edhe ndrojt koha edhe ndrova edhe bindjen time në mitologji, që nuk osht', në mite dhe mitologji ka shumë të pavërteta. Por, unë kom jetu me atë mitologji, me ato mite, me atë besim që ne jemi popull fisnor. Por tash, meqenëse i kom kry shumë hesape po thom që s'osht' e vërtetë, asnjona, as dyta, as treta. Na qita që jemi tash kishim qenë edhe përpara.

**Erëmirë Krasniqi:** Çka po pikturoni tash në mungesë të miteve? Qysh e ka ndrru artit e ju?

**Rexhep Ferri:** Unë vetëm kom fillu, vërtetë tash jom ma shumë në laminë e letërsisë dhe eksperimentoj me vetëveten, kulturën time figurative e përzij me figurën time letrare dhe ose e qes në pikturë ose e qes në ndonjë shkrim timin. Një shkrim që e kom qitu tash po du me ju pytë juve për titull. {pauzon} "Fjala e parafjalës" po mendoj me ja lonë titullin. A osht' abstrakte, a osht' konkrete? Për mu osht' shumë konkrete se vizatimet që i ka bo njeriu shpellave, bizonin nuk osht' fjalë e shkrum, prandaj osht' fjalë e parafjalës.

**Erëmirë Krasniqi:** Po e kuptoj tash.

**Rexhep Ferri:** Tash po e kupton.

**Erëmirë Krasniqi:** Para gjuhës e kemi pasë imazhin.

**Rexhep Ferri:** Dhe unë tash po du me lonë titull, kush e merr vesh, kush s'e merr vesh, kush s'e merr vesh le të thotë, {lëkund dorën} "Ka rrshit, ka rrshit Rexhepi". Kështu që, unë tash jom shliku prej Rexhep Ferrit si krijus. Por, meqenëse ende jam në raport të mirë me matematikën, {pauzon} merrna me shumë sende që jonë, kanë një vlerë shumë të mirë kombëtare, por që ne i kemi shkatrru. Ne aq

kemi bo kangë të kqia popullore sa heroj e sa heroina, *ba ba ba* {onomatope}, sa lufta pa qenë lufta hiç. Sa Mic Sokola, mirë e tha Presidenti [Hashim Thaçi], tha, “Unë jom president i dy million presidentave”. Kjo folklore, por unë folklorin mundona me nxerr mitin nga folklori, me nxerr dhe e kom harru edhe vetëveten dhe pikturoj ose shkruj.

Por, kur ju kthena mi pa unë apet nuk kom mujt me ikë nga Rexhep Ferri, se 60 vjet jom marrë me atë punë. Ato kanë ndiku te unë. Por, çka ka të re? Ka të re se diçka që i kom harru i ka bo mirë kësaj pikturës. Piktura e tashit e imja, e viteve të fundit nuk thom që osht’ ma dramatike, ma e fuqishme nuk e thom, por edhe koha ka qenë atëherë ma dramatike, ma e fuqishme. Por jom shliru. Jom shliru për arsye se Picasso kur ka hy në atele me qato ngjyra që i ka pasë qaty ka pikturu, s’ka kqyrë që po i mungon një ngjyrë, e ka marrë tjetrën... dhe mua, jo më thonë disa, “Ka ma shumë ngjyrë piktura jote”, por ngjyrat blehen në dyqan more. Unë edhe atëherë i kom pa ngjyrat por ktu s’ka pasë ngjyrë {prek veten në pjesën e zemrës}, ktu ka qenë bardh e zi, andaj m’u ka dokë e tepërt me marrë. Unë, shife nuk është kopjim i folklorit. {bën me dorë drejt para vetës} Çka me të thonë.

**Erëmirë Krasniqi:** Osht’ interpretim?

**Rexhep Ferri:** E kom edhe njo që i shkon asaj, qitu osht’ {bën me gisht mrapa}, por nejtse tash s’kemi... Bash m’vjen mirë që kom qenë ma i lirë tash, por apet unë. E kom humb frikën. Kom shku aq larg sa që as vdekjes nuk i frigohna, sinqerisht po ju thom.

**Erëmirë Krasniqi:** Shumë me randsi për juve. Ok, zoti Ferri po mendoj që e kishim përbyll qitu intervistën.

**Rexhep Ferri:** P’e përmyll qitu (qesh), me qit fjali?

**Erëmirë Krasniqi:** Po, po më doket ma së miri me përmyll. E keni tejkalu vdekjen.

*[Video intervista është edituar]*

**Rexhep Ferri:** Mu kishte me më ardh edhe m’vjen shumë keq që brezi juj nuk qet emra ma të mëdhaj sesa që ka lanë shekulli i kaluar në kulturën tonë. Ne na kanë ndodhë shumë fatkeqësi, [A e ke ndalë? Flet me intervistuesën] shumë fatkeqësi na kanë ndodhë në jetën tonë kulturore. Njëqind vjet para {pauzon} Naim Frashërit, babës së Romantizmit tonë ka kalu Bajroni<sup>13</sup> në trojet shqiptare, baba i Romantizmit botëror, lordi anglez Bajroni ka kalu dhe i ka ndëgju te Ali Pashë Telepena kangët popullore që kanë qenë në nivelin e poezisë dhe ne s’i kemi shkru si poezi, por vjen fjala vetëm dy shembuj t’i marrë, [reciton] “O bylbyl të bëra benë në të gjetsha dot folenë, do ta marrë ta hedh në lumë, se na lanë çupat pa gjumë”. Po poezia shqiptare, antologjia e poezisë shqiptare, e Romantizmit duhet me fillu me të ose me atë tjetrën, [reciton] “Ulu në mal të dali hana, ulu mal”, mali u ul por hana s’doli. Tash, *tra la la, tra la la* {onomatope}.

<sup>13</sup> Lord Byron (1788-1824) ka qenë poet dhe politikan anglez, dhe një ndër figurat kryesore të Romantizmit.

E kemi në artet figurative Eduard Lir [Edward Lear]<sup>14</sup>. S’di sa e njeh ti Eduard Lirin? Mandej ta tregoj nëse e kom ktu. Mandej, e kom një libër të Eduard Lirit të botum në anglisht para dyqind vjete në Amerikë. Osh’t’ ekzemplar i rrallë që ato pikturat e tij jonë grafika. Pse jonë grafika? Atëherë nuk ka ekzistuar shtypi i rrafsh, tash qiky shtypi {bën me dorë në veprat në të djathtë} fuku fuku. Ka ekzistuar shtypi i nalt ose shtypi i thellë dhe ai libër është i botum me dy teknika, teksti, ditari i tij është me shtypin e nalt, pikturat e tij janë me shtypin e thellë gdhendja në pllakë, si grafikate e Fatmir Krypës. Peisazhet e tij, se ai ka qenë peisazhist i mirë, ai rasisht ka ardhë në Shqipëri, krejt Shqipërinë e ka shetitë. Kur e ka lshu Shkodrën në ditar e ka aty, i thotë Gjelë Kokotit që e ka pasë, që e ka përcjellë gjatë tanë jetën edhe që e ka vorros e e ka lanë me gojë, e ka bo vorrin e vet ngat tij, me to osht’ i vorrosun, me Gjelë Kokotin. Ai ka qenë një vagabond, një djalë që u rrit në anije poshtë e përpjetë, e ka msu herë turqishten e herë greqishtën, italishten, frangjishten, anglishten. Tonë kohën nëpër anie t’u shku e tu i shërby edhe qato e ka marrë. Drita e peisazheve të Eduard Lirit ende nuk ekziston në peisazhin shqiptar.

**Erëmirë Krasniqi:** E peisazhet janë prej cilave pjesë?

**Rexhep Ferri:** Jo, jo prej peisazheve shqiptare, se aty janë vetëm krejt kalatë edhe krejt Shqipërinë ai e ka vizitu dhe i ka aty në libër, por tash s’muj m’u çu pa, nuk e di a e kom këtu a në shpi. Atë dritë nuk e kemi përdorë asnjëri nga piktorët. Flas për kohën e Romantizmit edhe të Realizmit. Në peisazhin tonë ka hy drita natyrale, ka hy drita artificiale, ka hy drita e Realizmit Socialist që ka qenë shminka që po i bojnë tash kuklla “Barbi” që po i bojnë femrat, por drita hynore nuk ka hi. Në persazhet e Eduard Lirit është edhe drita hynore edhe mu m’vjen keq. Bile ma bon një mik, “Pse nuk e shkrun?” Po s’po muj bre tash i kom unë vjet e mia s’muj me...

Nuk është përsërit ëajo dritë hyjnore, prandaj ne kemi kalu nëpër do vështirësina. 500 vjet na ka robnu njëfarë terri kulturor e në të njejtën kohë ka qenë edhe shpirtëror. Anën shpirtërore vetëm e ka majt {pauzon} mendja e popullit në kangët e veta të msime përmendësh, dhe atëherë kanë mujt një mijë vargje me i ditë përmendsh. Qitash unë as dhjetë vargje të librave të mi s’i di përmendsh. Pse? Jom i mbështetun se jonë aty dhe unë kur jom me vetëveten nuk du me pa kërkond. Në atë sekond që e kryj kom qef me u taku me dikënd që e du, po m’ka hangër dreqi tash nuk janë mo ata njerëz që unë i njoh. Nuk osht’ mo as njeriu që unë e kom njoft. Njeriut jo që, nuk e di a i ka hup rruga a jo, por njeriu është tu e kërkun njeriun për mu mbështet në diçka, se Zotin ka fillu me e harru se po i pengon ose nuk ekziston për to ose çka po di unë, nuk po hi në ato elemente. Njeriut nuk po i beson, atëherë po vjen puna që as dora e majt dorës të djathtë mos me i besu. Njeriu është bo ma egoist, ma egoist. Kur thom ma egoist, me ia dhonë gjysën e Botës thotë, “Valla pak osht’ ama edhe gjysën tjetër”...

<sup>14</sup> Edward Lear (1812-1888) ishte një artist anglez, ilustrues, muzikant, autor dhe poet.

